

## RAPORT PARAPRAK I VNM DENIM FACTORY'S Sh.P.K.



Linja e rrobaqepsisë fason, prodhim i konfeksioneve dhe veshjeve, tekstileve, të pambukta dhe të leshta të të gjitha llojeve, larje dhe ngjyrosje të tekstileve dhe të konfeksioneve. Prodhim i veshjeve të gatshme artizanale të të gjitha llojeve, import, eksport dhe tregtim me shumicë e pakicë i stofrave, tekstileve të tjera dhe lëndë e parë ndihmëse, makineri dhe pajisje të tjera prodhimi për tekstilet dhe veshjet.

Shtojca II, Pika 8 b)

Janar 2016

## Raport Paraprak i VNM Denim Factory's Sh.p.k.

### Informacion mbi Projektin:

**Titulli i projektit:** Vlerësim Paraprak i Ndikimit ne Mjedis

**Emri i raportit:** RAPORT PARAPRAK I VNM DENIM FACTORY'S SH.P.K.

Linja e rrobaqepsisë fason, prodhim i konfeksioneve dhe veshjeve, tekstileve, të pambukta dhe të leshta të të gjitha llojeve, larje dhe ngjyrosje të tekstileve dhe të konfeksioneve. Prodhim i veshjeve të gatshme artizanale të të gjitha llojeve, import, eksport dhe tregtim me shumicë e pakicë i stofrave, tekstileve të tjera dhe lëndë e parë ndihmëse, makineri dhe pajisje të tjera prodhimi për tekstilet dhe veshjet.

**Vendodhja** Qarku Durrës, Rrethi Durrës, Bashkia Durrës (komuna Xhafzotaj) , Adresa:  
Stacioni i Zooteknise Xhafzotaj, Autostrada Tirane-Durrës

**Autoriteti kontraktues:** DENIM FACTORY'S SH.P.K

**Aprovuar:** Brisilda SARACI

*Brisilda Saraci*

Person Fizik

Lic. Nr. Idetifikues.73, Nr. 4995 Prot; date 04.07.2013



**Permbajtja e lendes**

1	Informacion mbi qëllimin e VNM dhe metodikën e ndjekur .....	5
2	Kuadri ligjor mjedisor dhe institucional .....	6
3	Përshkrim i metodikes se ndjekur për hartimin e raportit paraprak te VNM-se.....	10
4	Përshkrimi i aktivitetit.....	11
5	Karakteristikave fizike te zonës se projektit .....	24
5.1	Gjeologjia .....	24
5.1.1	Gjeomorfologjia .....	24
5.1.2	Stratigrafia.....	24
5.1.3	Neotektonika.....	26
5.2	Sizmologjia .....	26
5.2.1	Tektonika rajonale dhe sizmiciteti .....	26
5.2.2	Tektonika dhe sizmiciteti ne territorin shqiptar .....	27
5.2.3	Termetet historike dhe instrumentale ne Shqiperi .....	28
5.3	Tektonika dhe sizmiciteti ne zonen e Studimit .....	29
5.3.1	Tektonika ne zonen e studimit.....	29
5.3.2	Termetet historike ne rajonin e studimit.....	29
5.3.3	Klasifikimi sizmologjik i zones se studimit.....	31
5.4	Burimet ujore .....	32
5.4.1	Ujrat nentokesore .....	32
5.4.2	Cilesia e ujrave nentokesore .....	35
5.4.3	Ujrat siperfaqesore .....	36
5.4.4	Cilesia e ujarve siperfaqesore .....	38
5.5	Mjedisi atmosferik .....	41
5.5.1	Karakteristikat klimaterike.....	41
5.5.2	Temperatura e ajrit.....	41
5.5.3	Rreshjet .....	43
5.5.4	Era .....	43
5.6	Ajri.....	45

5.6.1	Cilesia e ajrit.....	45
5.6.2	Zhurmat.....	46
5.7	Ekonomia dhe punesimi.....	47
5.7.1	Ekonomia .....	47
5.7.2	Punesimi.....	50
5.7.3	Arsimi .....	52
5.7.4	Shendetesia.....	53
5.8	Perdorimi tokes.....	53
5.8.1	Probleme te tokave bujqesore e joprodhuese .....	53
5.8.2	Perdorimi i tokave bujqesore dhe siteve arkeologjike si siperfaqe ndertimi .....	53
5.8.3	Ndotja e tokes .....	54
5.8.4	Furnizimi me uje.....	54
5.8.5	Ujrat e ndotura.....	54
5.8.6	Mbetjet urbane .....	55
5.8.7	Transporti publik dhe sherbimet .....	57
5.8.8	Turizmi.....	59
6	Ndikimet e mundshme negative në mjedis. ....	60
6.1	Burimet e ndikimit ne mjedis.....	60
7	Mjediset e prekur dhe masat kryesore zbutese.....	61
7.1	Peisazhi .....	61
7.2	Ajri .....	61
7.3	Mjedisi gjeologjik .....	62
7.4	Burimet ujore .....	62
7.5	Mjedisi biologjik.....	62
7.6	Mjedisi socioekonomik .....	62
7.7	Permbledhje e ndikimeve kryesore ne mjedis.....	63
8	Ndikimi ne mjedis dhe masat zbutese.....	63
8.1	Ajri .....	63
8.2	Zhurmat .....	63
8.3	Ndotja e ujrave dhe tokes.....	64
8.4	Aksidente, keqfunksionime, ngjarje te paparashikuara.....	65
9	Plani i menaxhimit mjedisor .....	65
10	Monitorimi .....	66
11	Konkluzione .....	67

## Raport Paraprak i VNM Denim Factory's Sh.p.k.

Aneksi 1: Lista e makinerive dhe pajisjeve.....	68
Aneksi 2: Lista e preparateve dhe substancave te perdorura ne procesin e punes .....	76
Aneksi 3: Kontrata e qirase .....	77
Aneksi 4: Certifikatat e pronesise .....	81

## 1 Informacion mbi qëllimin e VNM dhe metodikën e ndjekur

Ky vleresim i ndikimit ne mjedis eshte nje proces qe percakton dhe vlereson efektet apo ndikimet ne mjedis te kesaj veprimtarie. Ky proces aplikohet perpara se te merret vendimi dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i kesaj VNM eshte:

- Te jape informacion per vendimarrjes per pasojat mjedisore te aktivitetit te vleresuar; dhe
- Te promovoj zhvillim te qendrueshem duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis

Zhvillimi i Qendrueshem eshte nje koncept baze i perhapur dhe pranuar ne rang nderkombetar gjate dy dekadave te fundit. Strategjite dhe planet kombetare per zhvillimin e qendrueshem, theksojne rendesine e vendimarrjes se integruar te mjedisit dhe te zhvillimit dhe promiovimin e VNM dhe instrumenteve dhe politikave te tjera per kete qellim.

Qellimi dhe objektivat e kesaj VNM ndahen ne dy kategori.

Qellimi i pare, i drejtperdrejte, eshte te informoje procesin e vendimarrjes duke identifikuar rreziqet potenciale ne mjedis si dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit te propozuar. Qellimi perfundimtar, afatgjate i VNM eshte te promovoj zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk minojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitetit si dhe te njerezëve qe lidhen apo varen nga ky aktivitet.

Objektivat afatshkurtra dhe te drejtperdrejte te VNM:

- Identifikim i masave te duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme te aktivitetit;
- Perdorim eficient te burimeve natyrore;
- Informim i organeve vendimarrrese, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit;

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguria dhe mbrojtja e shendetit te njeriut dhe mjedisit;
- Parashikimi dhe perjashtimi i ndryshimeve te pakthyeshme dhe demtimeve serioze ne mjedis;
- Mbrojtja e burimeve natyrore, pesiazheve te natyres dhe komponenteve perberes te ekosistemeve; dhe
- Permiresim i aspekteve sociale si rrjedhoje e zbatimit te ketij projekti.

## 2 Kuadri ligjor mjedisor dhe institucional

Per hartimin e ketij raporti eshte analizuar kuadri ligjor i renditur me poshte. Eshte verifikuar permbushja e kerkesave ligjore te legjislacionit perkates.

- Ligji Nr. 8934 datë.05.09.2002: “Për mbrojtjen e Mjedisit”

### I ndryshuar me:

- Ligjin Nr.9890, datë 20.03.2008
- Ligjin Nr.9983, datë 08.09.2008
- Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009
- Ligjin Nr.10 431 , date 09.06.2011

- Ligji Nr. 9010 datë 13.02.2003: “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”

### I ndryshuar me:

- Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009

- Ligji Nr.8102 datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura"

### I ndryshuar me:

- Ligjin Nr. 9352, datë 3.3.2005
- Ligjin Nr. 9915, datë 12.5.2008

- Ligji Nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”

### I ndryshuar me:

- Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009

- Ligji nr.8990 datë 23.01.2003, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

### I ndryshuar me:

- Ligjin Nr.10 050, datë 24.12.2008
- Ligjin Nr.10 440 , datë 07.07.2011

- Ligji 10448 date 14.07.2011 “Per lejet e Mjedisit”

## Raport Paraprak i VNM Denim Factory's Sh.p.k.

- Ligji Nr.9115 datë 24.07.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura".
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".
- Ligji Nr.9379, datë 28.04.2005, "Për efikasitetin e energjisë".
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit"
- Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura".

### Indryshuar me:

- Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008

- Ligji Nr.10 081, datë 23.02.2009 për "Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 8094 datë. 21.03.1996: "Për largimin publik të mbeturinave"
- Ligji Nr. 9010 datë 13.02.2003: "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta"

### Indryshuar me:

-Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009

- Ligji nr. 9108, datë 17.7.2003 "Për Substancat dhepreparatet kimike"
- Ligji nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis"
- Ligji nr. 10463, datë 22.9. 2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"
- VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve"
- VKM Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse"
- VKM Nr. 835, datë 28.12.2005 "Për miratimin e listës së mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve dhe mbeturinave të tjera, që ndalohen të importohen, me qëllim ruajtjeje, depozitimi dhe asgjësimi"
- VKM Nr.805, datë 4.12.2003 "Për miratimin e listës së veprimtarive që ndikojnë në mjedis, për të cilat kërkohet leje mjedisore"
- VKM Nr.806, datë 4.12.2003 "Për miratimin e rregullave të procedurave për importimin e mbetjeve, për përdorim, përpunim dhe riciklim"
- VKM Nr.103 datë 31.03.2002, "Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë"
- VKM Nr. 395, datë 21.6.2006, "Për miratimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për zhvillimin e turizmit, kulturor dhe mjedisor"
- VKM Nr.435 datë 12.09.2002, "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"



- VKM Nr.267, datë 24.4.2003 “Për procedurat e propozimit dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike”
- VKM Nr.247, datë 30.04.2014 “Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin”.
- VKM Nr.114, datë 27.01.2009 për “Marrjen e masave emergjente, për përmirësimin e situatës së sigurisë dhe të veprimtarive në instalimet, që shërbejnë për depozitimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”.
- VKM Nr.824, datë 11.12.2003 “Për klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme”
- VKM Nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”
- VKM Nr. 13, datë 4.1.2013 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”
- VKM Nr. 100, date 3.2.2008 “Per percaktimin e substancave te rrezikshme”
- VKM Nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”
- VKM Nr. 453, datë 23.6.2005 “Për miratimin e listës së pajisjeve që përdorin lëndë ozonholluese”
- VKM Nr. 459, date 22.7.1998 “Per substancat e rrezikshme”
- VKM Nr. 803, date 4.12.2003 “Per miratimin e normave te cilesise se ajrit”
- VKM Nr. 853 dt.28.12.2005; “Per miratimin e listes se mbetjeve te rrezikshme”
- VKM Nr. 13 dt. 04.01.2013; “Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis”
- UDHËZIM Nr.6, datë 27.12.2006, “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimeve në mjedis të një veprimtarie”
- UDHËZIM Nr.6527, datë 24.12.2004, “Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre”
- UDHËZIM, Nr.5, datë 28.12.2007, “Për tarifatat e shërbimit për lejet mjedisore”.
- UDHËZIM, Nr.6, datë 27.11.2007, “Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta”.
- UDHËZIM, Nr.1, datë 07.01.2008, “Për dokumentacionin e domosdoshëm për të kërkuar leje mjedisore”.

Konventat Ndërkombëtare

## Raport Paraprak i VNM Denim Factory's Sh.p.k.

Konventa e Aarhus per akses ne informacion, pjesemarrje te publikut ne vendim marrje ambjentaliste dhe akses te drejtesise ne ceshtjet ambjentaliste, te ratifikuar me Ligjin Nr. 8672, date 26 tetor 2000,

Konventa e Rio De Janeiro-s per Biodiversitetin, te ratifikuar me 10 Nentor 1996,

Konventa per Vleresimin e Ndikimit në Mjedis në kontekstin ndërkuftar ESPOO, Finlandë, me 25 shkurt 1991


Konventa për Ruajtjen e Florës dhe Faunes së egër dhe mjedisit natyror të Europës Ne Bernë, 19 shtator 1979

Konventa e Stockholmit:Mbi ndotesit organike te qendrueshem. Ligji nr. 9263, date 29.07.2004

### 3 Përshkrim i metodikes se ndjekur për hartimin e raportit paraprak te VNM-se

Per hartimin e ketij raporti u ndoq metodologjia e sugjeruar nga Ligji i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis si dhe hapat e sugjeruar nga VKM "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis". Sipas percaktimit te ligjit ne shtojcen 2, piken 8b, ky aktivitet duhet te paraqese nje rapor paraprak te vleresimi te ndikimit ne mjedis. Autoret e raportit kryen konsultimet e nevojshme per hartimin e ketij raporti. U kryen nje sere takimesh e konsultimesh me specialistet e me personelin teknik te aktivitetit per te kuptuar ne detaj te gjitha aspektet e mundeshme te ndikimeve ne mjedis si rrjedhoje e funksionimit me kapacitet te plote te aktivitetit. Per nje vleresim sa me cilesor te matjes se ndryshimit te parametrave mjedisor, eshte konsideruar mjedisi natyror perpara zhvillimit te projektit duke marre si reference mjedisin natyror ne kete zone. Zona ku ushtrohet aktiviteti ka patur me pare karakter bujqesor dhe blegtoral. Megjithate shume prej parcelave qe rrethojne aktivitetin nuk perdoren per funksionet e mesiperme. Ne sistemin e kaluar keto toka kane sherbyer per bujqesine intensive por me ndryshimet e dhjetevjecareve te fundit ato e kane humbur funksionin e tyre te dikurshem. Ka nje fragmentarizim te larte te tokave perreth aktivitetit si dhe shnderrim te destinacionit te tyre. Fragmentarizimi i larte dhe shnderrimi i destinacionit i kane kthyer produktet e mundshme bujqesore te ketyre tokave, jo kompetitive ne treg dhe si rrjedhoje shume parcela jane djerre. Nje faktor tjetër qe influencon perdorimin bujqesor te parcelave eshte degradimi i sistemit te kanalizimeve vaditese qe veshtireson me tej perdorimin korrekt te ketyre tokave. Me ngritjen e aktiviteve te reja me karakter industrial ne kete zone po shfaqen gjithnje e me shume aktivite te reja industriale. Gjithashtu ndertimet e shumta si ato industriale dhe ato rezidenciale ne tokat e dikurshme bujqesore kane sjelle nje fragmentarizim te larte te territorit. Nje nga veshtiresite e hasura gjate hartimit te raportit ka qene mungesa e informacionit per planet e detajuara vendore te zones. Plani i detajuar vendor do te lehtesonte vendimarrjen per menytrat e perdorimit te tokes ne zonen ne fjale si dhe do te ndihmonte ne vleresimin e ndikimeve te mundshme ne mjedis te aktiviteti te propozuar ne kontekstin e zhvillimit lokal. Ne konsiderimin e efekteve te aktivitetit ne mjedis ato jane marra parasysh edhe efektet e mundshme gjate periudhes se operimit te perditshem te aktiviteti si dhe efekteve afatgjate si rrjedhoje e ushtrimit te ketij aktiviteti. Jane marra parasysh gjithashtu edhe efektet akumulative dhe ndikimi i tyre i mundshem ne mjedis dhe ne shendetin e njeriut. Te gjitha vleresimet e ndikimeve jane bere ne baze te njohurive te disponuara gjate kohes se hartimit te ketij raporti duke konsideruar teknikat me te mira te disponueshme per aktivitetin ne fjale. Rezultatet dhe gjetjet e ketij vleresimi jane diskutuar me grupin menaxhues te aktivitetit me qellim marrjen e masave per zbutjen e secilit efekt ne mjedis. Aktiviteti ka zgjedhur te operoje duke zbatuar politiken e tij mjedisore e cila bazohet mbi parimet e zhvillimit te qendrueshem dhe te minimizimit te efekteve te funksionimit te aktivitetit ne mjedis. Ky aktivitet ka zbatuar nje politike te rrepte mjedisore qe ne fazat e projektimit te tij. Pergjegjesia mjedisore e aktivitetit verehet ne masat e shumta te ndermarra per zbutjen e ndikimeve nga shkarkimet e mundshme ne ajer apo ne uje si dhe ne sistemin e ngritur per menaxhimin te mbetjeve. Aktiviteti ka marre persiper nje kosto te dedikuar drejtperdrejt, permiresimeve te vazhdueshme ne fushen e zbutjes se efekteve te ushtrimit te aktivitetit ne mjedis. Theksojme se shume nga vleresimet e permbledhura te ndikimeve ne mjedis mbesheten ne informacionet inxhinierike qe duhet te merren parasysh. Vleresimi identifikon ne menyre te qarte si perfitimet pozitive dhe negative dhe percakton perfundime te pergjithshme per secilen prej tyre. Vleresimi identifikon nese ndikimet jane mesatare te pranueshme, te rendesishme, te drejtperdrejta apo te terthorta.

## 4 Përshkrimi i aktivitetit



### Vendodhja e aktivitetit

Aktiviteti ndodhet ne krahun e djathte te autostrades Tirane – Durres ne ndertesën e kompanise Meshkurti. Qendrat e banuara me te medha ne afersi te aktivitetit jane: Xhafzotaj, Sukth, Rrashbull, Vrians dhe natyrisht qyteti i Durresit. Ky aktivitet ndodhet rreth 2 km nga pjesa lindore e qytetit te Durresit. Ne lindje te aktivitetit, ne nje distance prej rreth 4 kilometrash kalon lumi i Erzenit qe eshte edhe trupi me i madh ujqor ne kete fushe.



## Raport Paraprak i VNM Denim Factory's Sh.p.k.



Kufiri i aktivitetit dhe koordinatat e tij.


<b>Pika</b>	<b>Zona</b>	<b>E</b>	<b>N</b>
1	34 T	374934.93 m	4578495.67 m
2	34 T	374881.71 m	4578480.68 m
3	34 T	374943.93 m	4578396.97 m
4	34 T	374984.06 m	4578420.67 m

Koordinatat UTM te aktivitetit

<b>Pika</b>	<b>Zona</b>	<b>X</b>	<b>Y</b>
1	4	4375021.07	4580464.05
2	4	4374975.68	4580436.20
3	4	4375023.09	4580372.74
4	4	4375066.56	4580393.47

Koordinatat Gauss - Kruger te aktivitetit

Aktiviteti ndodhet larg zonave te mbrojtura sic duket edhe ne harten me poshte. Zonat e mbrojtura me te aferta jane (13) Qafe Shtama, (10) Mali i Dajtit dhe (40) Rrushkulli.



Vendodhja e aktivitetit dhe zonat e mbrojtura me te aferta.

Aktiviteti i kompanise Denim Factory Sh.p.k. mund te pershkruhet ne tre kategori kryesore. Ne ate te prodhimit te veshjeve te ndryshme, ne ate te sektorit te lavanderise dhe ne repartin e hekurosjes.

Nr rendor	Emertimi i treguesve	Njesia e matjes	Sasia
--------------	----------------------	--------------------	-------

A. Te dhenat e aktivitetit

1.	Siperfaqja trualli totale	m <sup>2</sup>	4999
2.	Siperfaqe kapanoni	m <sup>2</sup>	3000
3.	Kapaciteti max. i linjes se prodhimit te rrobave	kg/dite	700
4.	Kapaciteti max. i lavanderise	kg/dite	1000
5.	Kapaciteti max. i hekurosjes	kg/dite	500

Pas mberitjes se lendes se pare (copave) ne aktivitet, ato magazinohen ne mjediset perkatese ne sektorin e prodhimit te veshjeve. Ketu fillon edhe procesdi i prodhimit sipas planit te punes se aktivitetit.



Magazina e copave (lendeve te para) te perdorura ne fabrike

Copat priten ne makinerite prerese sipas kerkesa te planit te prodhimit. Ky proces eshte gjysem i mekanizuar. Pajisjet e perdorura jane listuar te anekset e raportit nen listen e makinerive te perdorura nga aktiviteti. Shumica e makinerive te perdorura ne proces punojne me energji elektrike.



Procesi i prerjes se copave sipas kerkesave te prodhimit

Pasi perfundon procesi i prerjes copat dergohen ne linjen perkatese te prodhimit te veshjeve. Linja e prerjes se copave punon ne funksion te linjes se prodhimit.

Kapanoni ku zhvillohet procesi i prerjes se copave ka hapesire e ndricim te bollshem. Ne te punonjesit levizin lirisht dhe mjedisi i punes eshte i mirembajtur dhe i mire organizuar.



Reparti i pare i rrobaqepsise.

Pas prerjes se copave sipas nevojave te prodhimit. Behet qepja e pare e veshjeve te cilat do te kalojne neper disa procese te tjera pune perpara perfundimit te tyre. Edhe ne kete repart hapesira e levizjes dhe ndricimi si ai natyror dhe artificial jane te bollshme. Pas qepjes se pare veshjet dergohen sipas llojit dhe procesit te tyre te punes ne repartet e tjera te fabrikes.



Pjese copezash te mbetura nga procesi i prerjes dhe i qepjes se pare.

Nga procesi prerjes dhe i qepjes se pare te veshjeve mbeten disa pjese te copave te cilat nuk sherbejne me per procesin e punes. Ato grumbullohen ne mjedisin perkates dhe largohen nga aktiviteti pasi formohet nje sasi e mjaftueshme. Keto cope merren nga indivite ose pale te treta qe mund ti perdorin per procese te tjera prodhimi veshjesh apo punimesh artizanale.

Veme re se ne kete pjese te aktiviteit nuk prodhohen mbetje per vete natyren e procesit (prerje dhe qepje e copave). Makinerite dhe pajisjet jane elektrike gje qe nuk ndikon ne cilesine e ajrit brenda mjedisese te punes dhe gjithashtu edhe ne mjedisin e jashtem.





Magazina e aksesoreve

Ne qender te hapësirave të brendshme të fabrikës ndodhet magazina e aksesoreve. Në të mbahen llojet e ndryshme të aksesoreve që përdoren në procesin e punës si zinxhire, kopsa, lidhese etj.



Magazina e aksesoreve

Mjediset e brendshme ne magazine jane te mire organizuara dhe bollshme dhe te mbajtura paster. Ambalazhet e perdorura palosen dhe vihen ne riperdorim ne pjese te tjera te ciklit te prodhimit. Ne kete mjedis nuk gjenerohen mbetje per vete natyren e punes aty. Materialet e magazinuar nuk kane skadence apo kushte te vecanta ruajtje.



Reparti i i hekurosjes dhe paketimit.

Ne repartin e hekurosjes dhe te paketimit te veshjeve kryhen me rradhe keto dy procese. Hapesirat e mjediseve te punes jane te bollshme dhe te mirembajtura. Llojet e ndryshme te veshjeve te prodhuara apo ne proces prodhimi sillen ne kete repart sipas planit te punes.



Ndricimi mjediseve te punes.

Mirembajta dhe sidomos ndricimi tregojne per nje miremenaxhim te mjediseve te brendshme te punes. Ne kete repart nuk gjenerohen mbetje. Pajisjet e perdorura jane hekurat per hekurosjen e veshjeve.



Paketimi i prodhimit

Abalazhet perdorura ne reparte te tjera te aktivitetit riperdoren ne fund te procesit per disa nga produktet qe duhen ripaketuar.



Gjeneratori i avullit

Mjetet kryesore te punes jane hekurat per hekurosjen e veshjeve te cilet punojne me nxehtesi te gjeneruar me energji elektrike si dhe me avull. Avulli sherben per zbutjen e copave dhe hekurosjen sa me te mire te tyre. Gjeneratori i avullit gjendet ne kete repart dhe me ane te nje sistemi tubash shperndan avullin ne cdo njesi hekurosje ne cdo banke pune.



Magazina e kimikateve

Ne hyrje te repartit te lavanderise e ngjyrosjes ndodhet edhe magazina e kimikateve. Te gjitha solucionet apo preparatet kimike te nevojshme per ngjyrosjen apo per krijimin e efekteve te ndryshme kromatike qe mund te kene veshjet e prodhuara dhe kryesisht panatallonat e prodhuara ne kete fabrike, mbahen ne kete mjedis. Mjedisi eshte i vecuar dhe i izoluar nga mjediset e tjera. Nje liste e plote e substancave kimike te ndodhura ne kete magazine jepet ne anekset e raportit.

Reparti i i lavanderise perbehet nga lavatricet e medha dhe pajisjet e tjera ndihmese te ketij procesi. Lista e plote e makinerive te perdorura ne kete repart dhe karakteristikave teknike te tyre eshte dhene ne anekset e raportit.



Reparti i lavanderise

Te gjitha pajisjet e ketij reparti jane montuar dhe mbahen ne funksionim sipas kerkesave specifike te seciles aparature. Mjedisi i brendshem eshte relativisht i zhurmshem ne rastin e punes me kapacitet te plote te kesaj linje. Ambientet e brendshme jane te bollshme dhe te ndricuara mire si me ndricim natyror ashtu edhe me ndricim artificial. Te gjitha mjediset e brendshme jane te mbajtura paster dhe te rregullta.



Kaldaja per ujin e ngrohte

Uji i perdorur ne procesin e larjes ngrohet ne repartin e kaldajes ne pjesen e prapme te repartit. Uji i perdorur shkarkohet me ane te sistemit te brendshem te kanalizimeve ne dekantuesin fundor te sistemit dhe me pas ne kanalim qe pershkron kufirin verior te aktivitetit.



Sistemi i brendshem i shkarkimit te ujrave te lavatriceve dhe depozita e dekantimit.

Ne kete repart nuk prodohen mbetje. Shkarkimet e vetme ne mjedis jane ato te ujrave te perdorura ne proceset e ndryshme te lavanderise.

### Reparti i rifiniturave dhe qepjeve



### Reparti i rifiniturave

Edhe ky repart eshte ne funksion te llojit te veshjes qe po prodhohet. Aty realizohet sipas teknikave specifike te kompanise rifinitura e veshjes se prodhuar. Shume prej produkteve te realizuara nga kompania marrin perpunimin e tyre perfundimtar ne kete repart. Teknika specifike e perdorur ketu perben edhe nje nga karakteristikat e produkteve te kompanise per te cilat ajo eshte e mirenjohur ne treg. Ne kete repart nuk prodhohen mbetje. Natyra e punes eshte e tille qe ketu realizohen lloje te vecanta hekurosje apo palosje si dhe aplikim me teknika te posacme te aksesoreve te ndryshem.

Magazina e produkteve te mbaruara dhe e produkteve te tjera ne proces perpunimi ndodhet ne qender te kapanonit. Edhe ajo eshte nje hapësire e mirembajtur dhe e organizuar sipas nevojave te punes se kompanise. Kuptohet qe nga funksioni i saj qe ketu nuk gjenerohen mbetje.



Magazina e produkteve

Uji i perdorur ne proceset e larjes duhet te jete i paster dhe i filtruar. Kjo realizohet me ane te vaskave te dekantimit te cilat ndodhen ne pjesen e jashtme te nderteses. Kjo njesi dekantimi perbehet prej dy vaskave te cilat funksionojne ne sekuence.



Vaskat e dekantimit te ujit per procesin e larjes.

Mbrapa vaskave te dekantimit kalon edhe nje nga kanalet drenazhues te fushes. Ai e pershkon kete pjese te fushes ne drejtimin lindje – perendim.

Në rajonin e Durrësit ka rezerva ujore te kufizuara, burimi i te cilave përfaqësohet kryesisht nga lumi Erzen, i cili, ne kete rajon, ushqehet edhe nga rrjedhjet sipërfaqësore të përrrenjve të Hardhishtës, Gjepalajt, Tonës, Rubjekës, Manezit Shkalles, Kodërlorit etj si dhe te rrjedhjeve te perkohëshme.

Per te evituar kthimin e fushës në moçalishte ujrat e rreshjeve derdhen nëpër sistemet e dendur të kanaleve të bonifikimit me drejtim veriperendim-juglindje dhe verilindje–jugperendim dhe pej andej me ndihmën e stacionit të pompave kalojnë në det të hapur. Gjithashtu jane ndertuar dhe nje sistem argjinaturash dheu per te ndaluar ndikimin e ujerave detare ne pjesen me veriore te fushes, nga Fshati Rinia e deri ne jug te zones kodrinore te Bishtit te Palles, qe do te sillnin kenetezimin e fushes.

Keto ujra jane te shellirta te cilat shplajne tokat e kripura te ish kenetes se Durrësit, toke e cila gjate stines se veres ze nje cipe te bardhe kripe. Kjo ndodh sepse vlerat e avullimit kapin kufirin maksimal te tyre. Gjithashtu keto ujera ndodhen dhe nen ndikimin e detit. Ujerat jane te tipit klorur-sulfat-natrium-magneziumi.



Kanali i shkarkimit ne kufi te aktivitetit



## 5 Karakteristikave fizike te zonës se projektit

### 5.1 Gjeologjia

#### 5.1.1 Gjeomorfologjia

Rajoni i Durrësit ben pjese ne Ultësirën Bregdetare. Në veri kufizohet nga Kepi Rodonit, ne jug nga lugina e Erzenit (Skoranë-Romanat) dhe skaji jugor i kodrave Rrashbull-Shënavlash. Në lindje kufiri kalon përgjatë ngritjeve monoklinale te Preze-Ishem, kurse në perëndim nga deti Adriatik.


Zona e projektit ndodhet ne fushen e Durrësit, e cila ben pjese ne Ultesiren Praneadriatike e cila, nga pikpamja gjeologjike, ben pjesë ne Basenin Paramalor te Albanideve, i cili ndërtohet përgjithësisht nga depozitime molasike.

#### 5.1.2 Stratigrafia

Si pjese perberese e Ultesires Praneadriatike rajoni i Durrësit ndërtohet nga depozitimet terrigjene të sistemit mio-pliocenik dhe kuaternarit që sipas përbërjes litologjike mund ti klasifikojmë në dy grupe të mëdha:

- formacioni molasik; dhe
- depozitimet kuaternare.

Formacioni molasik vendoset trasgresivisht me depozitimet e vjetra të nënshtruara dhe i përket moshave Miocen i mesem – Miocen i Sipërm – Pliocen.



Harta gjeologjike e rajonit te Durrësit (marre nga harta gjeologjike e Shqiperise 1:200 000, viti 2003)

Depozitimet kuaternare kanë përhapje të gjerë, duke mbuluar të gjithë pjesën e ulët të relievit. Në rajonin e Durrësit ato shfaqen me të gjitha tipet e tyre gjenetike: depozitime deluviale lagunore- kënetore, aluviale dhe detare.

Depozitimet detare ( $Q_4^{dt}$ ) përfaqësohen kryesisht prej rërave dhe surërave të akumulimit detar. Trashësia e këtyre depozitimeve arrin nga 2-3m deri ne 10m ne stere. Keto jane te vendosura transgresivisht mbi depozitimet Pliocenike.

Depozitimet aluviale ( $Q_4^{al}$ ) dhe lagunore kënetore ( $Q_4^{kt}$ ) mbushin rajonin bregdetar, ku trashësia e tyre 15-30m deri 50m. Përbëhet nga shtresa rere, zhavorre aluviale ujëmbajtëse me trashësi nga 5.0-7.50m deri 15.0m që mbulohet nga sipër prej suargjilave, argjilave e surerave (me trashësi nga 5-8m deri 20.0-30.0m)

Depozitimet lagunoro- kenetore ( $Q_4^{kt}$ ) mbulojne krejtesisht fushen e ish kenetes se Durrësit. J Perfaqesohen prej graveliteve, zhure e rera, qe shfaqen ndermjet shtresave suargjilore e argjilore. Gjithashtu prezente jane dhe ndershtresa rere te imet e torfe, me permbajtje mbeturinash bimore te pa dekompozuar mire.

Suargjilat e mbuleses lagunore-kenetore perhapen ne te gjithë fushen e Durrësit. Trashësia e tyre arrin deri ne 3m dhe mbulojne nga siper shtresat e rereve te imeta me trashesi nga 3-7 deri 11m. Nen shtresen e rereve jane vendosur argjilat e buta trashësia e te cilave luhetet nga 20-40m.

Nga ana tektonike, rajoni i Durrësit, ndahet në tre elemente strukturale: sinklinali i Erzenit të poshtëm, antiklinali i Kavajës dhe sinklinali i Durrësit.

Krahu lindor i antiklinalit të Durrësit ndërtohet nga argjila të miocenit të sipërm, nga pakoja e fuqishme e ndërshtresëzimeve të argjilave dhe ranorëve të moshës Pliocenike. Sipas të dhënave të puseve krahu lindor i kësaj strukture shkëputet tektonikisht.

### 5.1.3 Neotektonika

Ultësira pranadriatike është kapur fuqimisht nga një lëvizje shtypëse paspliocenike dhe është formuar nga rrudha, lartreshqitëse mbihypje dhe kundrahypje, si dhe shtytje. Lëvizjet shtypëse vazhdojnë edhe sot.

Në baze të intensitetit dhe kronologjisë së lëvizjeve vertikale, në Ultësirën anësore Pranadriatike veçohen këto elementë sipërfaqësorë:

- Ngritje mesatare të fuqishme që nga plioceni.
- Zhytje mesatare deri të fuqishme në pliocen dhe ngritje e dobët në kuaternar.


Spektori në detin Adriatik është kapur nga zhytja e fuqishme në pliocen dhe kuaternar. Deformimet shtypëse vazhdojnë deri në ditët tona. Si rezultat i fazës tektonike shtypëse të fundit, depozitimet kuaternare (detare ose kontinentale) shtrihen horizontalisht me mospajtim mbi strukturat miocen-pliocenike të rrudhosura.

Ultësira Pranadriatike, ku bën pjesë dhe rajoni i Durrësit, ndërtohet nga disa linja antiklinale relativisht të ngushta (nga studimet gjeofizike të kryera edhe në det) dhe sinklinale të gjera, lineare Mio-Pliocenike me shtrirje veriperëndim deri afër veriore. Antiklinalet Mio-Pliocenike vendosen mbi shkëputjet të tipit lartë rrëshqitës – mbihypës ose kundrahypës gjatësore dhe shkëputje tërthore të tipit shtytje që spostojnë linjat antiklinale (shtytja e djathtë midis Durrësit dhe Kryevidhit). Mbihypjet dhe kundrahypjet janë ende aktive në ditët tona, këtë e dëshmojnë tërmetet e fuqishme të gjeneruara prej tyre.

## 5.2 Sizmologjia

### 5.2.1 Tektonika rajonale dhe sizmiciteti

Shqipëria përfshihet në brezin orogjenik alpin mesdhetar, i cili është rezultat i lëvizjes së pllakave të mëdha tektonike (Afrika dhe Euroazia) dhe një sere pllakash të vogla (pllaka e Adrias). Territori shqiptar kufizohet, në perëndim të tij, me buzën lindore të mikropllakes së Adrias. Si rezultat i lëvizjeve shtypëse orogjenike, në brezat e rrudhosur që rrethojnë mikropllakën e Adrias, gjenerohet një aktivitet i lartë sizmik, i cili prek edhe vendin tonë.



Mikroplllaka e Adrias dhe tektonika rregjionale


### 5.2.2 Tektonika dhe sizmiciteti ne territorin shqiptar

Territori shqiptar karakterizohet nga nje aktivitet i larte sizmik. Ne figuren e meposhtme (fig.3.7) jepen vatrat dhe magnituda e termeteve instrumentale, te rregjistruar ne periudhen 1964-2000.

Pjesa me e madhe e epiqendrave te termeteve, me te fuqishem, qe prekin kete territor, shtrihen ne 3 breza sizmike (Sulstarova et al., 1980; Aliaj et al., 2004), midis te cileve ben pjese edhe brezi termotor Joniko-Adriatik, me orientim veriperendim-juglindje, i shtrire pergjate buzes lindore te mikroplllakes se Adrias. Thyerjet terthore qe kalojne ne veri te ishullit te Sazanit dhe prane qytetit te Lezhës, e ndajne kete brez, ne tre zona sizmogjene, nder te cilat edhe zona e Ultesires Pranadriatike (PL), ku ben pjese edhe rajoni i Durresit.

Fenomenet tektonike, qe prekin territorin e Shqiperise, u perkasin fazave te ndryshme rrudhosëse. Paraqitja aktuale e tyre lidhet me fazën e fundit rrudhosëse Plio-Kuatemare, e cila dallohet nga nje amplitude e larte e levizjeve tektonike. Gjate kesaj faze, perveç riaktivizimit te thyerjeve te meparshme, janë formuar edhe disa thyerje të reja, që në gjeologjinë shqiptare njihen me emrin tektonika e re pas Pliocenike.

Zona e Ultesires Praneadriatike (PL) karakterizohet nga shkeputje tektonike mbihypese oblike me shtrirje veri dhe veri-veriperendim, dhe prishje te rralla tektonike gjate shtrirjes me drejtimin lindje-verilindje.



Paraqitje skematike e zonave sizmogjene te vendit tone dhe termetet e matur qe kane sherbyer si baze per ndarjen e tyre. (Sipas Aliaj Sh. etj. 2004). Zona e studimit ndodhet ne brezin PL (Preadriatic Lowland: Ultesira Praneadriatike).


*Me rreth te kuq jane shenuar termetet me shkallen me te madhe te rrezikun, kurse rrathet gri perfaqesojne termetet e tjere. M < 2.0, M 2.0-2.9, M 3.0-3.9, M 4.0-4.9, M 5.0-5.9, M 6.0-6.9 dhe M 7.0 + perfaqesojne madhesine e shkalles se termeteve*

Vlerat e larta te potencialit sizmik, te kesaj zone, i detyrohen faktit se ajo ndodhet gjeografikisht prane ballit mbihypes te Orogjenit Shqiptar, ne konvergjence me Mikroplaken e Adrias. Amplituda e larte e levizjeve shtypese, qe lindin si pasoje e kesaj konvergjence, krijojn kushte per termete te forte, magnituda e te cileve arrin potencialisht deri ne M=7.0. (Aliaj Sh. etj. 2004).

### 5.2.3 Termetet historike dhe instrumentale ne Shqiperi

Pervec modelit tektonik, autoret (Aliaj et al, 2004 & 2007) e ndarjes se territorit te vendit tone ne 10 zona sizmogjene (LU, PL, IC, PP, KP, KO, ST, EDT, SK, EAB –(fig. ), jane mbeshtetur edhe ne katalogun e termeteve historike dhe instrumentale te vendit tone.

Me poshte jepen epiqendrat e termeteve historike dhe instrumentale, te Shqiperise, ku shihet se rajoni i studimit ben pjese ne nje zone me aktivitet te larte sizmik.



Epiqendrat e termeteve historike ne vendin tone

a-Epiqendrat e termeteve historike, per periudhen 58-1900 ( $M > 6.0$ ) -(Sulstarova E., et al., 2003)

b-Epiqendrat e termeteve historike, per periudhen 1900-2005 ( $M > 5.0$ ) -(Muco B. et al., 2002)

c-Epiqendrat e termeteve historike, per periudhen 1976-2005 ( $M > 3.0$ )- (Aliaj Sh. et al., 2007)

## 5.3 Tektonika dhe sizmiciteti ne zonen e Studimit

### 5.3.1 Tektonika ne zonen e studimit

Aktiviteti tektonik i zhvilluar pergjate shkeputjeve ne perendim dhe lindje te qytetit te Durrresit dhe njeve te nderprerjes se tyre, qendrojne ne origjinen e aktivitetit sizmik te kesaj zone.

### 5.3.2 Termetet historike ne rajonin e studimit

Bazuar ne ngjarjet sizmike, te pershkruara ne kronikat historike si dhe ne ato te rregjistruara ne stacionet sizmologjike, dhe qe njihen perkatesisht si termete historike dhe instrumentale, eshte marre nje informacion, relativisht i mjaftueshem, mbi zonat sizmogjene te territorit shqiptar.

Me poshte jepet nje renditje e termeteve me shkaterrues historike, per te cilet flasin kronikat e shkruara, si dhe e termeteve me te forte instrumentale (per te cilet ka rregjistrime vetem per rreth 100 vitet e fundit), qe kane prekur krahinen e Durrësit

*Vitet 58, 334,346, 506, 1273, 1617, 1852, 1860, 1926, 1934, 1970 dhe 1988.* (Sulstarova, Kociaj, 1975; Sulstarova et al., 2000).

*Viti 58* -Tërmet shkatërrues në Durrës me  $M_s = 6.3$  dhe  $I_o = 8.5$  ballë MSK-64

*Viti 334* -Tërmet shkatërrues në Durrës dhe fshatrat rreth tij. Vlerësohet si tërmet i madh, me pasoja katastrofike.  $M_s = 6.3, I_o = 8.5$  ballë MSK-64.

*Viti 346* -Tërmet shkatërrues në Durrës. Pati vale detare te larta, qe mbuluan qytetin.  $M_s = 6.6, I_s = 9$  ballë MSK-64.

*Viti 506* -Tërmet shkatërrues në Durrës dhe fshatrat rreth tij.

Sipas të dhënave historike, duke filluar nga shekulli i VI-të Durrësi pësoi rënime të mëdha nga tërmetet e fortë.  $M_s = 6.3, I_o = 8.5$  ballë MSK-64.

*Mars 1273*- Tërmet katastrofik, me magnitudo  $M_s = 6.6$  dhe intensitet  $I_o = 9$  ballë (klasifikimi MSK-64). Durrësi është shkatërruar plotësisht. Vetëm Akropoli mbeti pa u dëmtuar. Sipas Pachymeris ky qytet u shndërrua në një grumbull gërmadhash. Pati shumë viktima. Pati valë detare. Tërmeti u parapri nga shumë paragoditje. Durrësi ne atë kohë ishte një qytet me 25 000 banorë. Ata që mbetën gjallë u shpërngulën për në Berat.


*Durres, 1926* -Në Dhjetor te vitit 1926, Durrësi dhe rajoni rreth tij u goditen nga një sërë tërmetesh të fuqishëm. Goditja e parë ndodhi më 16 dhjetor ne orën 17h 54min. Kjo goditje u pasua nga të tjera, më të forta me 17 Dhjetor. Më 17 dhjetor 1926, në oren 06h 20', 06h 31',  $M=5.8$ , 06h 41min,  $M=4.6$ ; 08h 05min,  $M=4.2$ ; 10h48min,  $M=4.4$ ; 11h 39min 50s,  $M=6.2$ ; etj.

Dëmet më të medha i shkaktoi goditja e orës 11h 39min 50s, me magnitudo  $M_s = 6.2$  (sipas buletinit te Sarajeves  $M_s = 6.5$ ),  $I_o = 9$  ballë (MSK-64), e cila dëmtoi rëndë shumë ndërtesa në qytetin e Durrësit, Kavajës, Shijakut si dhe ne fshatrat përreth.

### 5.3.3 Klasifikimi sizmologjik i zones se studimit

Zona ne studim perfshihet ne zonen e burimeve sizmike te Ultesires Praneadriatike, te vleresuar me magnitude maksimale te pritshme te termeteve  $M_{max} = 7.0$ . dhe potenciali te intensitetit te pritshem sizmik VIII balle (klasifikimi MSK-1964), per kushte mesatare trualli dhe IX balle, per troje me kushte te keqia (ku ben pjese edhe sheshi i ndertimit te projektit).

Ne figuren e meposhtme paraqitet harta e rajonizimit sizmik të Shqipërisë në shkallën 1:500000, dhe pozicioni i rajonit te Duresit. Shihet se zona jone e studimit përfshihet në një zonë me lëkundje te pritshme sizmike me intensitet maksimal  $M_{max} = VIII$  ballë, klasifikimi MSK-64, te parashikuar per 100 vjet (me probabilitet 70%), në troje me veti mesatare fiziko-mekanike dhe IX ballë për troje me veti të këqija fiziko-mekanike.



Klasifikimi sizmologjik i zones se studimi, (Sipas hartes se rajonizimit sizmik te Shqiperise, shkalla 1:500000, viti 1980, Instituti i Sizmologjise, Tirane). Me rreth: zona e studimit. Me numra romake: intensiteti i pritshem sizmik per kushte mesatare trualli.



## 5.4 Burimet ujore

### 5.4.1 Ujrat nentokesore

#### ***Kushtet hidrogjeologjike te rajonit***

Rajoni i Durrësit ndërtohet nga depozitimet terrigjene të sistemit Mio-Pliocenik dhe Kuaternarit.

Duke u bazuar ne përbërjen litologjike dhe ne vecorite hidrogjeologjike te formacioneve qe ndertojne kete rajon, dallojme komplekset ujembajtese te formacionit Mollasik dhe depozitieve Kuaternare.

#### ***Komplekset ujembajtese te formacionit Mollasik***

##### *Kompleksi ujembajtës i depozitimeve te Miocenit (Mesiniani)*

Këto depozitime përfaqësohen kryesisht nga ranorë, konglomerate, shpesh me cimentim të dobët deri në të shkrufta. Këtu të pranishme janë dhe argjilat. Ka përhapje të kufizuar në rajonin e Durrësit. Ne pjesen perendimore te rajonit takohet ne Malin e Durrësit dhe Bishtin e Palles.

Depozitimet e miocenit në këtë rajon hyjnë në grupin e shkëmbinjve me ujëmbajtje lokale dhe resurse të kufizuara ujërash nëntokësorë, kanë vlera në shfrytëzim lokal për furnizimin me ujë. Ujërat e këtyre depozitimeve janë të ëmbla me mineralizim mestar 0.4-0.5 g/liter por që mund të arrije dhe 1.0 g/liter dhe me fortësi të madhe (mbi 30° gjermane). Karakteristike eshte permbajtja e larte e joneve sulfate ne ujrata e ketij kompleksi e justifikuar kjo nga prania e depozitimeve te gipsit ne kete formacion.

##### *Kompleksi ujembajtës i formacionit konglomeratik të Pliocenit (të pandarë)*

Duke analizuar kushtet hidrogjeologjike të formacionit konglomeratik te Pliocenit, horizonti ujëmbajtës konglomeratiko-ranor vendoset direkt nën depozitimet kuaternare, i vecuar nga një shtresë apo pako argjilore me trashësi 17 e deri ne 70-100 m. Horizonti në fjalë shtrihet në të gjithë fushën e Durrësit, duke filluar nga bregu Adriatik-Hamallaj, Porto Romano deri në lumin Erzen duke u shtrire ne jug deri ne gjirin e Durrësit.

Këta shkëmbinj përmbajnë rezerva të konsiderueshme ujërash nëntokësorë, që sipas tipit hidraulik mund të jenë ujëra carjesh ose poro-carjesh. Në të shumtën e rasteve janë arteziane dhe për nga pikëpamja e përbërjes kimike deri në thellësinë 250.0-350.0 m zakonisht janë të freskëta, ndërsa më në thellësi mineralizohen dhe disponojnë pression të madh të kolonës së ujit, që pas shpimit dalin me vetëderdhje në sipërfaqe.

Midis ujërave me presion të Pliocenit, ujrave te Kuaternarit dhe ujrave të grundit që janë sipër tyre nuk ka lidhje hidraulike gjë që vërtetohet nga ndryshimet e vetive të ujit si dhe nga ndryshimet e niveleve statike të tyre.

### *Cilesia e ujrave nentokesore te pliocenit*

Keto ujra kanë veti të mira kimiko-fizike, janë të kthjellëta, pa erë, me temperaturë rreth 15°C.

Përsa i përket përbërjes kimike të ujërave nëntokësorë në kolektorët ujëmbajtës të pakove ranoro-konglomeratike te Pliocenit, ne zonen e Porto Romanos analizat e shumta kimike kanë treguar se ato janë të tipit hidrokarbonat- magnezium- kalciumi, ose hidrokarbonat- kalcium-magneziumi, pH=7.50-8.50,  $M_{th} > 1000$  mg/l. Ndotja nga NO<sub>2</sub> dhe NO<sub>3</sub> mungon ose ka vetëm gjurmë. Në këtë zonë fortësia e përgjithshme nga juglindja në veriperëndim rritet gradualisht nga 25° gjermane deri 38° gjermane, relativisht e lartë.

Në disa pus-shpime të rajonit të Durrësit, ujërat nëntokësorë të depozitimeve ranoro-konglomeratike përmbajnë jone të Fe, që është mbi normën e lejueshme, dmth mbi 0.30 mg/l. Në keto puse, për shkak të përmbajtjes së hekurit, uji ka shijen e ndryshkut që në veri bëhet më i theksuar. Prania e jonit hekur vihet re në të gjitha shpimet e kryera, që kanë kapur trashësitë të mëdha konglomeratike. Si burime hekuri në ujërat nëntokësorë janë përberja e vete zajeve të konglomerateve nga mineralet e grupit silikat, alumosilikatet etj.

Në këto ujëra është i pranishëm dhe amoniaku, i cili mund të jetë si rrjedhim i vete konstruksionit jo brenda normave teknike të pusit i ndikuar nga ambientet e ndotura pranë shpimeve si psh pranë kanaleve vaditëse, zonave të banuara etj, ose mund të jete rrjedhojë e përmbajtjes së tij në vetë shtresën ujëmbajtëse të konglomerateve

### ***Kompleksi ujëmbajtës i depozitimeve të Kuaternarit***

Depozitimet e kuaternarit kanë përhapje të gjerë, duke mbuluar të gjithë pjesën e ulët të relievit, dhe shfaqen me të gjitha tipet e tyre gjenetike: depozitime deluviale, lagunore-kënetore, aluviale dhe detare.

Te dhënat e shpimeve të shumta të kryera në rajonin e Durrësit kanë treguar se kolektorët ujëmbajtës të Kuaternarit në këtë rajon lidhen kryesisht me:

- shtresat me përshkueshmëri të madhe të zhavorreve aluviale,
- shtresat me përshkueshmëri të vogël të rërave të imëta

Ku rezervat me të rëndësishme të ujërave nëntokësorë në shkëmbinjtë e shkrifët, ose ujërave të poreve lidhen me kolektorët e tyre kryesorë: depozitimet aluviale të kuaternarit.

### *Shtresat me përshkueshmëri të vogël të rërave*

Shtresa kolektorale e rërave të imëta detare që takohet në Porto Romano ka përshkueshmëri të dobët dhe veti kolektorale të uleta. Pompimet eksperimentale në shpimet e kryera, si dhe në pusët e gërmuara të kësaj zone kanë treguar se ujërat nëntokësorë të këtij horizonti ujëmbajtës janë të pakta dhe të kufizuara sepse ato kanë vetëm një burim ushqimi, reshjet atmosferike. Kjo mbështetet nga matjet e nivelit të kryera në pusët e gërmimit. Matjet

tregojne qe ato luhaten ne varesi te reshjeve atmosferike, nga 1-3.5m nga siperfaqja e tokes. Debiti i pergjithshem te puseve shkon deri ne 0.30 l/sek.

#### *Cilesia e ujrave te rerave*

Në drejtim të veriperëndimit, e me ne veri, këto ujëra të pakta nëntokësorë nuk kanë asnjë përdorim praktik, sepse janë me mineralizim të lartë dhe të kripura, të tipit klorur-sulfat-natriumo-magneziumi, me tregues pH=9.2-9.50 dhe ndodhen direkt nën influencën e vazhdueshme të ujërave detare.

Analizat kimike të ujërave të këtij horizonti për zonën tonë tregojnë se ka mineralizim të përgjithshëm mbi 1 gr/l. Pra kemi mineralizim të lartë. Kurse fortësia e përgjithshme është mbi 30° gjermane.

Nga analiza baktireologjike rezulton se ato janë në përgjithësi ujra të ndotura. Nga karakteristikat hidrogjeologjike të dhëna më sipër, sidomos nga ana cilësore, del se këto ujëra nuk mund të shfrytëzohen për furnizimin me ujë të pijshëm.

Ne zonen e Porto Romanos pervec faktoreve te mesiperem nje rol te rëndesishem luan dhe ndotja nga lendet kimike

#### Analiza kimike ne territorin e ish uzines kimike, Durres, viti 2000-sipas UNEP


Na+k	Ca	Mg	Fe <sup>2+</sup> +Fe <sup>3</sup>	NH <sub>4</sub>	HCO <sub>#</sub>	CO <sub>3</sub>	Cl	SO <sub>4</sub>	NO <sub>3</sub>	NO <sub>2</sub>	Mp	Mth	H <sub>2</sub> SiO <sub>3</sub>	Fp
mg/l	mg/l	mg/l	mg/l	mg/l	mg/l	mg/l	mg/l	mg/l	mg/l	mg/l	mg/l	mg/l	mg/l	°gjerm.
602.60	71.93	89.68	0.40	2.00	419.68	-	951.40	168.30	gjurme	3.50	2309.49	2184	25.94	30.69

#### Shtresat me përshkueshmëri të madhe të zhavorreve aluviale

Depozitimet aluviale te Kuaternarit ndjekin drejtimin e rrjedhjes se lumit Erzen. Ne Katund i Ri, Qerret e Fllage, kjo fushe aluviale zgjerohet ne drejtim te jugut ne Fshatin Rinia e zonen e Porto Romanos.

Shtresa ujëmbajtëse zhavorrore përbëhet nga kokrriza me dimensione të ndryshme, në të cilën takohen të gjitha fraksionet (zhavorr i trashë, i mesëm zhur dhe rërë).

Mbulesa e depozitimeve zhavorrore te kuaternarit perbehet nga tre forma te shfaqjes se tyre: suargjila, rëra dhe argjila. Subargjilat e mbulesës lagunore-kenetore mbushin pjesën më të madhe të fushës së Durrësit, ato përhapen ne formë gjuhe duke filluar rrëzë kodrave të krahut lindor, përfshijnë pjesën qendrore të ultësirës dhe mbyllen në veri-perëndim pranë kodrave të ish NB Durres e Porto Romanos. Subargjilat janë të shkrifëta me trashësi 2.0–3.0 m dhe mbulojnë nga sipër shtresën e rërave të imëta, me trashësi 3.0–8.0 m deri 15.0 m. Ujepershkueshmeria e tyre eshte e nje rendi mjaft te ulet.



Harta hidrogeologjike ne rajonin e projektit (sipas hartes hidrogeologjike te Shqiperise, shk. 1:200000, 1983)

Drejtimi i rrjedhjes së ujërave nëntokësorë është juglindje-veriperëndim, gjatë të cilit rryma e ujërave nëntokësorë nga juglindja drejtohet për në veriperëndim, me gradientin piezometrik mesatar 0.0033. Ne pjesen veriperendimore te pellgut parametrat hidrogeologjike te shtresës ulen ndjeshëm, ujepercjellshmeria zvogëlohet nen vlerat 200 m<sup>2</sup>/dite, koeficienti i filtrimit ka vlera relativisht te uleta nga 5-7-10 m/ditë. Po keshtu ulje te ndjeshme kemi dhe persa i perket prurjes per nje meter ulje qe luhetet nga 1.4-2.1 l/sek/m. Kjo ka bërë që dhe drenimi i ujërave nentokesore të jetë i vështirësuar.

#### 5.4.2 Cilesia e ujërave nentokesore

Ne depozitimet aluviale te Kuaternarit ne zonen e Porto Romanos eshte i perhapur tipi i ujit klorur- hidrokarbonat-natriumi. Ne pjesen me perendimore uji nga tipi klorur- hidrokarbonat-natriumi kalon ne klorur-natriumi me koeficient alkaliniteti 0.3-0.8, koeficienti i ujfreskimit 0.04-0.34 mineralizimi i pergjithshem kap vlerat 1.8-3.5 g/liter e madje deri 18 g/liter, praktikisht ujera te shellirta.

Mesataret e permbajtjes se joneve ne mgek/liter sipas analizave te kryera ne puset e hapura ne depozitimet e kuaternarit-zona e Porto Romanos.

Tipi i ujit	Na <sup>+</sup>	Mg <sup>+2</sup>	Ca <sup>+2</sup>	HCO <sub>3</sub> <sup>+</sup>	SO <sub>4</sub> <sup>+2</sup>	Cl <sup>+</sup>
Cl-HCO <sub>3</sub> -Na	68.75	20.10	14.32	7.59	3.38	92.3

Këto ujëra nëntokësorë përgjithësisht paraqesin koncentrimet e joneve Fe më të mëdha se normat e lejueshme, që arrijnë 0.50-0.90 mg/l. Megjithatë duke patur parasysh nevojat dhe kërkesat e mëdha të furnizimit me ujë të rajonit të Durrësit mund të përdoret si ujë për përdorim komunal.

Ujrat nëntokësorë pa presion të zonës së Porto Romanos, e më në veri, janë të pakta dhe nuk kanë asnjë përdorim praktik, sepse janë me mineralizim të lartë dhe të kripura, të tipit klorur-sulfat-natrium-magneziumi, me tregues pH=9.2-9.50 dhe ndodhen direkt nën influencën e vazhdueshme të ujërave detare.

Në zonën e Porto Romanos është identifikuar ndotja e ujërave në pusët e hapura me krahe, thellesia e të cilëve shkon deri në 12m. Nga analizimi i provave ka rezultuar ndryshimi jo vetëm i vetive fizike dhe organo-leptike si psh: uji është i turbullt me ngjyrë të verdhë deri në portokalli me erë të rëndë të kimikateve, por dhe nga analizat kimike rezultojnë me permbajtje të lartë të joneve Cl, SO<sub>4</sub>, si dhe permbajtje jashtë normave të metaleve të rënda.

Nga analizat bakterologjike rezultojnë se ujërat e grunit janë në përgjithësi të ndotura. Nga karakteristikat hidrogeologjike të përshkruara në kapitullin përkatës, sidomos nga ana cilësore, del se këto ujëra nuk duhet të shfrytëzohen për furnizimin me ujë të pijshëm, për blektorinë apo për vaditje, ndonëse një gjë e tillë nuk respektohet me rigorozitet nga popullsia e asaj zone.

### 5.4.3 Ujrat sipërfaqësore

Në rajonin e Durrësit ka rezerva ujore të kufizuara, burimi i të cilave përfaqësohet kryesisht nga lumi Erzen, i cili, në këtë rajon, ushqehet edhe nga rrjedhjet sipërfaqësore të përrenjve të Hardhishtës, Gjepalajt, Tonës, Rubjekës, Manezit Shkalles, Kodërlorit etj si dhe të rrjedhjeve të perkohëshme. Ndërsa pjesën më veriore të rajonit në studim e përshkon perroi i Tarinit, i cili derdhet në detin Adriatik.

Lumi i Erzenit fillimet e tij i ka në afërsi të Qafes së Gurakuqit në kuotën mbi 1300m mbi nivelin e detit, ndonëse grumbullon ujëra në kuota edhe më të larta. Siperfaqja e pellgut të tij është 760km<sup>2</sup> dhe gjatësi 109km. Kurse vetë lumi i Erzenit me gjatësi rreth 75.0 km dhe gjerësi 50.0-200.0m. Brënda rajonit tonë lumi i Erzenit ka gjerësi nga 40.0-50.0m deri 150.0-200.0m. Deget kryesore të lumit Erzen ndodhen jashtë rrethit të Durrësit dhe janë perroi i Zallit, perroi i Zhullimes, perroi i Pezes. Karakteristike e këtij lumi është që në rrjedhjen e sipërme përshkon Krahinën malore Qendrore, kurse në rrjedhjen e poshtme shtrihet në Ultesirën Perendimore.

Amplituda e lëkundjeve të nivelit të tij arrijnë 7.68m kurse në Porto Romano prurja mesatare shumëvjeçare e lumit arrijnë në 8.60m<sup>3</sup>/sek në Ibe, 14.5m<sup>3</sup>/sek në Ndroq dhe 18.0m<sup>3</sup>/sek në

Sallmone. Rregjimi i tij është i paqëndrueshëm. Ecuria e shpërndarjes së rrjedhjes ujore në pellgun ujëmbledhës karakterizohet nga rritje të shpejta që përsëriten disa herë gjatë vitit, nga një ujëshmëri që vazhdon për një kohë pak a shumë të gjatë, nga Porto Romano prurje të shumta në periudhën e lagët të vitit dhe nga një zbritje e theksuar e tyre gjatë periudhës së thatë. Një ecuri e tillë kushtëzohet kryesisht nga natyra e regjimit klimatik, nga shpërndarja në kohë dhe në hapësirë e reshjeve atmosferike. Kështu nga matjet shumevjecare të kryera në stacionin e Ndroqit del që 65% e rrjedhjes ujore të lumit Erzen të jete nga ushqimi sipërfaqësor dhe vetëm 35% të jete nga ushqimi nëntokësor. Rrjedha mesatare e periudhës së lagët të vitit ndryshon nga  $11.8\text{m}^3/\text{sek}$  në vendmatjen në Ibë në  $24.2\text{m}^3/\text{sek}$  në Sallmone kurse në periudhën ujëpakët rrjedha minimale ditore është përkatësisht për vendmatjet e mësipërme  $1.83\text{m}^3/\text{sek}$  dhe  $2.75\text{m}^3/\text{sek}$ . Gjatë sezonit të dimrit kur rreshjet janë të shumta, uji është mjaft i turbullt si pasojë e gërryerjeve erozionale të mëdha të brigjeve të tij. Depozitimet fundore gjate shtratit të rrjedhjes së Erzenit karakterizohen me zvogelimin e diametrit mesatar të tyre nga burimi deri në derdhje.

Perberja kimike e ujrave të lumit është hidrokarbonate. Në rrjedhjen e poshtme përmbajtja e të gjithë joneve ndryshon duke marrë vlera të larta.

Rajoni i Durrësit konsiderohet si rajon i varfër në rrjedhjet sipërfaqësore, gjë që është kompensuar me ndërtimin e shumë rezervuarve artificialë. Nga studimet e bëra për sasinë e ujërave nëntokësore të këtij rajoni vërehet një sasi shumë e vogël e tyre, për më tepër duke e krahasuar me rajonet e tjerë bregdetarë që dallohen për resurse të mëdha ujrash nëntokësore.

Zona e Porto Romanos përben pjesën veriperendimore të fushës së ish kenetes së Durrësit. Kjo e fundit, me shtrirje prej Shkëmbit të Kavajës e Shkozetit në juglindje dhe deri në Bishtin e Pallës në veriperëndim, ndodhet afërsisht në kuotë të njëjtë me nivelin e detit. Në pjesët anësore të fushës kuota ngrihet deri në  $1.40\text{m}/\text{abs}$ , ndërsa në pjesët qendrore të saj kjo kuota ulet deri në  $0.44\text{m}/\text{abs}$ . Në pjesën veriore verilindore dhe jugore fusha e Durrësit kufizohet nga vija bregdetare e detit Adriatik, ajo është e hapur nga ana e detit dhe në këto drejtime ka patur lidhje direkte me atë ndërmjet dy kanaleve komunikues, Gjirit të Durrësit dhe Porto Romanos. Ujërat e reshjeve që zbresin nga faqet e kodrave konturuese të rajonit së bashku me ujrata e kripura detare kanë qarkulluar lirisht nëpërmjet këtyre dy kanaleve duke krijuar një rrjedhje të rregullt ujore nga Porto Romano deri në grykëderdhjen e vendit të quajtur Ura e Dajlanit. Sot të dy këto kanale komunikues janë mbushur me aluvione detare e kontinentale.

Për të evituar kthimin e fushës në moçalishte ujrata e reshjeve derdhen nëpër sistemet e dendur të kanaleve të bonifikimit me drejtim veriperëndim-juglindje dhe verilindje–jugperëndim dhe pejë andej me ndihmën e stacionit të pompave kalojnë në det të hapur. Gjithashtu janë ndërtuar dhe një sistem argjinaturash dhe për të ndaluar ndikimin e ujërave detare në pjesën me veriore të fushës, nga Fshati Rinia e deri në jug të zonës kodrinore të Bishtit të Palles, që do të sillnin kenetëzimin e fushës.

Keto ujra janë të shellirta të cilat shpëllajnë tokat e kripura të ish kenetes së Durrësit, tokë e cila gjatë stinës së verës zë një cipe të bardhë kripe. Kjo ndodh sepse vlerat e avullimit kapin kufirin maksimal të tyre. Gjithashtu keto ujera ndodhen dhe në ndikimin e detit. Ujërat janë të tipit klorur-sulfat-natrium-magneziumi.

#### 5.4.4 Cilesia e ujarve siperfaqesore

Raporti i joneve te Mg me Ca eshte afersisht 5 me 1, i krahasueshem me ate te ujit te detit ku ky raport arrin deri ne 6. Si pasoje e permbajteses se larte te jonit te Mg, fortesia e pergjitheshme arrin vleren e 3710 gjermane. Uje eshte alkaline me pH = 9.50. Sasia e lendes organike eshte ne vlerat e 6.40 mg/l.

Ndikimin kryesor ne cilesine e ujrave bregdetare te gjirit te Porto Romanos e kane shkarkimet e hidrovorit i cili bart ujrat e zeza te qytetit te Durresit dhe qendrave te banuara ne afersi te kanalit.

Mungesa e impiantit te pastrimit te ujrave te zeza per Durresin, shkakton edhe ngarkesen e konsiderueshme ndotese te ujrave qe derdhen nga ky kanal ne det.



Hidrovori i Porto romanos dhe shkuma ne dalje te ujrave te ndotura prej tij

Nga analizat e kryera nga Instituti Mjedisit eshte gjetur se permbajtia e oksigjenit te tretur ne ujrat pas hidrovorit eshte 1,33 mg/l O<sub>2</sub>, ndersa 10 m mbas shkarkimit te ujrave te ndotura ne det kjo vlere rritet ne 4,81 mg/l O<sub>2</sub>. Vlerat respektive te fosfateve (si fosfor total) rezultojne 7,08 mg/l P<sub>t</sub> dhe 1,7 mg/l P<sub>t</sub>. Ndotja nga fosfori lidhet me sa duket me perdorimin e detergjenteve me fosfor. Ne fakt edhe ne aspektin vizual, ujrat mbas stacionit te pompave te hidrovorit kane permbajtje te larte shkume. Edhe vlerat e Nevojes Kimike per Oksigjen (NKO) dhe te Nevojes Biokimike per Oksigjen (NBO), paraqiten te larta, respektivisht 82,50 mg/l O<sub>2</sub> 29,85 mg/l O<sub>2</sub> per NKO dhe 29,25 mg/l O<sub>2</sub> 9,75 mg/l O<sub>2</sub> per NBO<sub>5</sub>.

Gjate vitit 2006 analizat, referuar mesatares se kater mostrave, ne hidrovorin e Porto Romanos, tregojne ne pergjithesi nivele te larta te ndotjes, sikedhe ne tabelen ne vijim.

Tab. Vlerat e tregueseve te ndotjes ne hidrovorin e Porto – Romanos per vitin 2006

D1 – Stacioni i pompimit (Hidrovori) ne Porto – Romano (Spitalle), Durres			
Treguesit	Norma	Mes 06	Gjendja
NBO <sub>5</sub>	25 mg/l	44.75 mg/l	Jashte norme
NKO	125 mg/l	93.25 mg/l	Brenda norme

## Raport Paraprak i VNM Denim Factory's Sh.p.k.

Lendet pezull	35 mg/l	51 mg/l	Jashte norme
Fosfori total	1 mg/l	3.54 mg/l	Jashte norme

Burimi: Agjensia e Mjedisit dhe e Pyjeve

Gjithashtu edhe ndotja bakterologjike eshte pertej normave te lejuara. Nje situate e till e ben zonen per rreth vend shkarkimit te ujrve te ndotura ne det te pa papershtshem per perdorim balnear.

Ne Raportin mbi Gjendjen e Mjedisit per vitet 2003 – 2004, ujrat e hidrovorit ne Porto Romano jane klasifikuar “maksimalisht te ndotura”.

### Permbytjet

Pjesa veriperendimore te fushes se Spitalles, qe eshte pjesa me e prekur nga ky fenomen, ndodhet afërsisht në kuotë të njëjtë me nivelin e detit. Në pjesët anësore të fushës kuota ngrihet deri në 1.40m/abs, ndërsa në pjesët qendrore të saj kjo kuota ulet deri në 0.44m/abs. Në pjesën veriore verilindore dhe jugore fusha e Durrësit kufizohet nga vija bregdetare e detit Adriatik, ajo është e hapur nga ana e detit dhe në këto drejtime ka patur lidhje direkte me atë ndërmjet dy kanaleve komunikues, Gjirit të Durrësit dhe Porto Romanos. Ujërat e rreshjeve që zbresin nga faqet e kodrave konturuese të rajonit së bashku me ujrat e kripura detare kanë qarkulluar lirisht nëpërmjet këtyre dy kanaleve duke krijuar një rrjedhje të rregullt ujore nga Porto Romano deri në grykëderdhjen e vendit të quajtur Ura e Dajlanit. Sot të dy këto kanale komunikues janë mbushur me aluvione detare e kontinentale.

Per te evituar kthimin e fushës në moçalishte ujrat e rreshjeve derdhen nëpër sistemet e dendur të kanaleve të bonifikimit me drejtim veriperendim-juglindje dhe verilindje–jugperendim, prej nga nepermjet stacionit të pompave kalojnë në det të hapur. Gjithashtu jane ndertuar dhe nje sistem argjinaturash dheu per te ndaluar ndikimin e ujerave detare ne pjesen me veriore te fushes, nga Fshati Rinia e deri ne jug te zones kodrinore te Bishtit te Palles, qe do te sillnin kenetezimin e fushes.

Keto ujra jane te shellirta dhe shplajne tokat e kripura te ish kenetes se Durrësit, te cilat gjate stines se veres ze nje cipe te bardhe kripe. Kjo ndodh sepse vlerat e avullimit kapin kufirin maksimal te tyre. Gjithashtu keto ujera ndodhen dhe nen ndikimin e detit.

### *Tokat*

Sipas klasifikimit te Bankes Boterore, tokat ne zonen e ne fjale dhe perreth saj, u perkasin tipeve Calcik Luvisol (LVcc) dhe Gleic Solloncak (SCgl). Keto toka kane per origjine fluvicet dhe gleicet. Ne to dallohet qarte horizonti cambic.

Ne rajonin e Durrësit, ato gjenden kryesisht ne zonen depressive te bregdetit. Keto toka kane përmbajtje te larte kripe. Formimi i profilit te tyre eshte kontribut i aktivitetit aluvial ne periudhen e Holocenit. Thellesia e ketij profili eshte relativisht e madhe dhe luhatet nga 1.5 deri ne 2.0m. Gjate gjithë trashesise se profilit spikatin shtresat e ndryshme, ne te cilat dallohen qarte prania e ngjyres dhe larmia e madhe e njesive tokesore, kryesisht haplik, molik, calcik, gipsik, stanjik dhe gleik. Guret mungojne gjate gjithë thellesise se profilit te tyre.






Fig. Harta e tipit te tokave (sipas WRB) dhe profili pedologjik i tokave ne afersi te objektit

Ne tre horizontet e para (0-20cm, 20-40cm dhe 40-90cm) lageshtia eshte vazhdimisht e pranishme, ndersa ngjyra eshte gri.

Ne keto horizonte, struktura eshte kendore. Pershkueshmeria e sistemit rrenjor te bimesise se kultivuar dhe asaj spontane, eshte aktiv ne shtresat e sipërme, ndersa me rritjen e thellesise fillon e dobeshet.

Ne horizontet e tjera, mbi 90 cm thellesi, kemi nje ndryshim te dukshem te ngjyres, aktivitet te dobët te sistemit rrenjor, prishje te struktures se tokes dhe per rrjedhoje edhe mungesa te poreve te saj.

Per gjate gjithë gjatesise se profilit, vlerat e aciditetit qendrojne te pa ndryshuara. Per pH uJOR, keto vlera shkojne nga 8.3 deri 8.7, ndersa per pH kripor nga 7.4 ne 7.5. Rritja e pH-it kripor dhe atij uJOR lidhet drejtperdrejt me thellesine e profilit te tokave.

Nga pikpamja e grimcometrisë, keto toka perfshihen ne tipin argjlor. Ne te gjithë profilet e analizuar rezulton se grimcometria e tokes eshte ne vlerat e meposhtme:

18.2%	rere;
33.3%	lyme; dhe
48.5%	argjile me permbajtje te larte lageshtie

Kapaciteti i kembimit kationik eshte gati i barabarte per te gjitha shtresa e profilit, ne vlerat 35 deri 36.6. Ndersa raporti Ca/Mg eshte 15.36 / 10.1.

Sipas nje studimi te Landell Mills Ltd (Rapid EA for Industrial and Energetic Park's at Porto Romano, Durres Albania, May 2008), nuk ka te dhena per nivelin e ndotjes se tokes per munges te perfshirjes te perfshirjes se kesaj zone ne Programin e Monitorimit Mjedisor. Toka konsiderohet e kripur dhe mundet e ndotur nga permytjet e shpeshta, prej ujrave te ndotura.

## 5.5 Mjedisi atmosferik

### 5.5.1 Karakteristikat klimaterike

#### *Pershkrim i mjedisit atmosferik*

Pozita gjeografike në skajin perëndimor të vendit përgjatë buzës së Adriatikut, shtrirja meridionale veri-jug, në trajtën e nje rripi relativisht të ngushtë me gjerësi jo më shumë se 50 km, ndikimi aktiv i detit, relievi i ulët fushor dhe kodrinor, vargmalet që e rrethojnë nga lindja me shtrirjen e tyre karakterisike veriperëndim-juglindje dhe që e mbrojnë nga erërat e ftohta dhe të forta kontinentale, janë faktore themelore që kushtëzojnë veçoritë klimatike të rajonit të Durrësit.

Vleresimi i vecorive klimaterike te ketij rajoni eshte bere duke u bazuar ne te dhenat shume vjecare te vrojtuar ne periudhen 1965-1990, ne stacionet metereologjike te qytetit te Durrësit dhe ate te Sukthit.

#### *Diellezimi dhe rrezatimi diellor*

Rajoni merr sasi të mëdha orësh diell. Vlera e zgjatjes vjetore të diellezimit lëviz në kufijtë 2600-2700 orë. Edhe numri i ditëve me diell lëviz nga 320-330 ditë. Vlerat me te larta jane vrojtuar ne korrik ndersa me te ultat ne dhjetor.

Edhe rrezatimi diellor ndjek pothuaj te njejtën shperndarje vjetore si dhe diellezimi. Energjia diellore mesatare gjate nje viti eshte 1600 kWhore /m<sup>2</sup>. Vlerat me te larta jane vrojtuar ne korrik, dhe me te ultat ne dhjetor.

Diellezimi (ore) dhe rrezatimi diellor per rajonin e Durrësit (kWh/m<sup>2</sup>)

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Diellezimi	130	137	180	217	283	327	373	342	271	216	142	118
Rrezatimi diellor	60.2	79.3	116.5	145.9	185.7	212.4	223.5	203.1	149.7	103.1	67.7	52.9

### 5.5.2 Temperatura e ajrit


Relievi fushor dhe ndikimi i detit Adriatik kushtëzon në përgjithësi një uniformitet të kushteve klimatike të rajonit. Ky ndikim shprehet në vlera mesatare të minimeve absolute, të cilat vijnë duke u ulur nga bregdeti në brendësi. E njëjta gjë ndodh dhe me vlerat mesatare të maksimeve absolute, por ndryshimi i tyre bëhet në kah të kundërt, pra zvogelohen nga brendësia në bregdet.

Temperatura mesatare e ajrit, në periudhën e muajit janar arrin 7-8oC, ndërsa gjatë korrikut dhe gushtit luhatet nga 23oC, në brendësi, deri në 26oC buzë detit. Temperatura mesatare vjetore e rajonit të Durrësit është rreth 16oC. Efektet zbutese të afersise se detit në ultësirën bregdetare të rajonit pasqyrohen në numrin e diteve me ngrica, që janë të rralla (5-10 dite), si dhe i diteve me temperature me të larte se 30 oC (rreth 35 dite). Ditët me ngrica verehen kryesisht gjatë sezonit të dimrit, në muajt dhjetor, janar dhe shkurt. Në tabelën e mëposhtme janë dhënë disa nga parametrat kryesore karakteristike të temperaturës.

Parametrat klimatologjike të temperaturës së ajrit

Temperatura (°C)	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Mesatare (°C)	7.1	8.3	9.2	13.2	17.7	21.0	22.8	23.2	20.3	15.4	11.8	8.0
Max abs(°C)	19.0	20.3	27.2	27.0	34.5	36.5	39.8	36.6	34.7	29.6	25.4	20.5
Min abs(°C)	-6.6	-6.5	-3.0	1.5	3.0	8.5	9.7	11.5	2.5	-1.5	-4.0	-5.6
Amplituda (°C)	25.6	26.8	30.2	25.5	31.5	28.0	30.1	25.1	32.2	31.1	29.4	26.1

Temperaturat mesatare mujore, minimumet dhe maksimumet kanë pothuajse të njëjten shpërndarje vjetore, siç janë paraqitur dhe në grafikun e mëposhtëm.




Mesatarja mujore e temperaturave të ajrit

### 5.5.3 Rreshjet

Rajoni i Durresit bën pjesë në brezin e rreshjeve mesatare vjetore 1000-1500mm. Sasia dhe shpërndarja e tyre, në këtë rajon, pëson ndryshim hapësor. Rreshjet kanë tendencë të rriten nga perëndimi në lindje. Muajt më të lagësht janë nëntori dhe dhjetori. Gjysma e ngrohtë e vitit karakterizohet nga rreshje të pakta. Në Korrik e Gusht sasia e rreshjeve është minimale (rreth 20.2 mm). Periudhat e thatesirës zgjasin 8-10 javë dhe në vite të veçanta 10-12 javë. Bora është fenomen i rrallë, ndërsa breshëri vërohet në çdo stinë, por më shpesh në dimër, 3-8 ditë në vit.

Mesataret shumëvjeçare mujore të regjimit të rreshjeve.

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Reshjet (mm)	134.7	113.3	101.9	90.3	68	51.8	29.1	45	67.8	114	160.3	133.3




Shpërndarja mujore e rreshjeve

### 5.5.4 Era


Shpejtësia dhe regjimi i erës ndikohen nga deti Adriatik, për shkak të cilës erës ka karakterin e puhizës detare, veçanërisht gjatë sezonit të nxehtë, dmth gjatë ditës erës fryn nga deti në tokë, ndërsa gjatë natës në drejtim të kundërt. Drejtimi mbizotëruar i erës ndryshon sipas stinëve. Drejtimi i dytë i erës në këtë zonë është drejtimi jug-lindje me një frekuencë 16.7%. Gjithashtu edhe drejtimi veri-lindje është i pranishëm gjatë periudhës së ftohtë të vitit me një frekuencë rreth 12-13%.

## Raport Paraprak i VNM Denim Factory's Sh.p.k.



Trendafili vjetor i drejtimit dhe shpejtesise se eres

Ne kete zone verehen shpejtesi te larta ere pamvaresisht nga stina e vitit. Izopletat e shpejtesise mesatare te eres per vendmatjen perfaqesuese te Durrësit jane paraqitur me poshte. Nga analiza rezulton se shpejtesi te konsiderueshme te eres vihen re edhe ne oret e mengjesit dhe te mbasdites.



Izopletat e shpejtesise se eres per vendmatjen Durrës

## 5.6 Ajri

### 5.6.1 Cilesia e ajrit

Monitorimi i cilesise se ajrit ne pergjithesi dhe i ajrit urban ne vecanti eshte nje praktike e viteve te fundit qe kryhet ne disa nga qytet kryesor te Shqiperise.

Megjithate si vend matjet ashtu dhe frekuenca e matjeve jane te pakta per te krijuar nje tablo te qarte te cilesise se ajrit, ne qytetet objekt i monitorimit.

Nga te dhenat e tabelës me poshte per cilesin e ajrit ne qytetine Durrës, eshte e veshtire te behen pergjithesime ne nivel qyteti vetem me matjet ne nje pike. Ne pergjithesi, konstatohet pothuaj e njejta dukuri qe vihet re edhe per qytetet e tjera kryesore te vendit; ndotja mbi normativat e lejuara nga lendet e ngurta pezull (LNP) dhe PM 10.

Rezultatet e monitorimit te ajrit per Qytetin e Durrës (prane DSHP)

Vend marrja e mostres (Drejtoria Shendetit Publik)	LNP µg/m <sup>3</sup>	PM10 µg/m <sup>3</sup>	SO <sub>2</sub> µg/m <sup>3</sup>	NO <sub>2</sub> µg/m <sup>3</sup>	O <sub>3</sub> µg/m <sup>3</sup>	Pb µg/m <sup>3</sup>
Viti	2001	2001	2001	2001	2001	2001
	226			17	25	
Viti	2002	2002	2002	2002	2002	2002
	272	124		27	66	0,473
Viti	2006	2006	2006	2006	2006	2006
	201	93	19	24	106	0,28
Viti	2007	2007	2007	2007	2007	2007
	211	100	23	15	99	0,26
VKM Nr. 803, dt 04.12.2003	140	70	60	60	120	1
Normativae eBE	70	40	40	40	110	0,5
Rekomandimi OBSH	60	30	50	40	110	0,5

Burimi:Raporti Gjendjes se Mjedisit 2006. Raporti Gjendjes se Mjedisit 2007

## 5.6.2 Zhurmat

Zhurmat eshte nje ndotes fizik i mjedisit qe ne nivele te caktuara mund te jete me pasoja ne shendetin e njeriut dhe faunen.


Te dhenat per nivelet e zhurmes, ashtu si dhe per cilesine e ajrit urban disponohen per disa nga qytet kryesor te vendit. Bazuar ne matjet e kryera nga Institutit Shendetit Publik, qyteti i Durrësit renditet i dyti pas atij te Tiranës si qyteti me i ndotur nga zhurmat. Trafiku rrugor, hekurudhor dhe detar, aktivitet ndertimore dhe zhurmat ne mjediset publike e kane rritur se tepermi nivelin e zhurmes.

Vlerat mesatare te monitorimit te zhurmes, ditën dhe natën, per qytetin e Durrësit, viti 2006

Nr	Pikematja	Vlera mes.diten	Vlera mes. naten
1	Hyrja ne Durres	71 dB (A)	53 dB (A)
2	Perballe prefekrures	68 dB (A)	50 dB (A)
3	Kryqezimi i portit	69 dB (A)	49 dB (A)
4	Drejtoria e higjenes	70 dB (A)	48 dB (A)
5	Tek spitali	67 dB (A)	46 dB (A)
6	Tek ish mapoja	69 dB (A)	45 dB (A)

Per te patur nje tablo me qarte te nivelit te zhurmave jo vetem per qytetin e Durrësit por edhe qytet e tjera kryesore te Shqiperise dhe te krahasuar per vitet 2005 dhe 2006, po japim me poshte ne menyre grafike nivelet mesatare te zhurmave.

Sic vihet re nga grafiku i me poshtem, qytetet Tirane dhe Durres jane me problematiket per nivelin e larte te zhurmave qe gjenerojne si ditën dhe natën, ku vlerat jane rreth 70 Dba gjate dites dhe rreth 48-58 Dba gjate nates.



Niveli i zhurmave ne qytetet kryesore te Shqiperise

## 5.7 Ekonomia dhe punesimi

### 5.7.1 Ekonomia

Pozicioni gjeografik, kushtet e mjedisit dhe burimet njerëzore i kanë dhënë rajonit të Durrësit një rol të rëndësishëm në ekonominë kombëtare. Vizioni i zhvillimit ekonomik të rajonit të Durrësit është i lidhur ngushtësisht me zhvillimin e transportit përfshirë atë detar, hekurudhor, ajror e tokësor; zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit dhe zhvillimin e përshpejtuar të bujqësisë me krijimin e fermave të mesme e të mëdha.

Rajoni i Durrësit paraqet fuqi të shumta ekonomike, duke u renditur në vendin e dytë pas rajonit të Tiranës. Pozicioni i Rajonit të Durrësit në qendër të Shqipërisë, vendosja e portit më të madh të vendit, fuqitë investuese nga dërgesat e emigrantëve dhe burimet natyrore për zhvillimin e turizmit, kanë favorizuar zhvillimin e disa sektorëve të ekonomisë rajonale dhe krijimin e një numri të madh të ndërmarreve aktualisht aktive.

Krijimi i sektorit privat, i cili në fillimet e viteve 90-të ishte i dobët dhe i pafuqishëm, sot ka krijuar dhe ofron vende pune për rreth 32 përqind të fuqisë punëtore duke zbutur papunësinë. Sektorë si peshkimi, industria, dikur me rëndësi në jetën ekonomike të shumë banorëve të këtij rajoni, i kanë lënë vendin sektorëve të ndërtimit, tregtisë, industrisë së lehtë ushqimore dhe shërbimeve, të cilat ofrojnë punësim për rreth 30 përqind të fuqisë punëtore.

Ne rrethin e Durrësit janë aktualisht në aktivitet 3511 subjekte ekonomike, midis të cilave 64 shoqeri të përbashkëta (Filanto, Floryhen, Triumph, Eurotech), etjer që merren me rieksporin e konfeksioneve të kepuceve, peshkut etjer.



Ne tabelen me poshte jane paraqitur nderrmarjet e pranishme ne rrethin e Durresit dhe ndarja e tyre sipas aktiviteteve

Numri i nderrmarrjeve, ne rrethin e Durresit, sipas fushes se veprimtarise perkatese

Emërtimi	Rrethi Durres
Prodhim	523
Ndertim	177
Tregti	2838
Transport	450
Sherbime sociale, personale	1393
Gjithsej rrethi	5378

Burimi: Drejtoria e statistikave Durres, 2006.

Te dhenat e mesiperme japin nje panorame te nderrmarrjeve aktive sipas aktivitetit qe operojne ne qarkun e Durresit., ku vihet re, se nderrmarrjet kryesisht te llojit tregtar zene 51% dhe jane ne pergjithesi nderrmarrje me permasa te vogla si ne prodhim ashtu edhe ne punesim. Perjashtohet ne kete drejtim sektori i ndertimeve, qe edhe pse ka nje peshe te vogel (rreth 3.3%), dallohet per nderrmarrje me permasa te medha.

Ne Qarkun e Durresit ushtrojne veprimtarine e tyre 6561 nderrmarrje, kryesisht te llojit tregtar.

Ne pergjithesi shohim se mbizoterojne nderrmarrje vetiake ose te vogla me nje punonjes (rreth 78%) e nderrmarrjeve aktive, ndersa nderrmarjet e medha si nga numuri i punonjesve ashtu edhe nga teknologjia qe perdorin perfaqesojne 10% te tyre.

Numuri i pergjithshem i te punesuarve (i vleresuar rreth 66.097) ne keto nderrmarrje ndahet ne menyre jo homogjene midis punesimit publik dhe atyre privat dhe brenda ketij te fundit sektorit bujqesor dhe jo-bujqesor. Sektori bujqesor thith pjesen me te madhe te krahut te punes, duke punesuar rreth 34.706 njerez.

Tabela e meposhtme jep informacion per punesimin sipas sektoreve per vitin 2006.

Ndarja e Fuqise punetore sipas sektoreve

Sektori	Nr. te punesuarve
Publik	8617
Privat	17932
Bujqesor	18335

Fuqia punetore per ndermarrjet jo- bujqesore, private dhe shtetore (Buletini Statistikor Durres-Kruje 2006) kap shifrat 26 594 punonjes dhe shperndahet ne menyre jo uniforme sipas degeve te ndryshme te ekonomise.

Shperndarje e fuqise punetore sipas sektoreve te ekonomise

Ndermarrje ekonomike jo bujqesore	26549
-Bujqesi	105
Pyje peshkimi	137
Industria nxjerrese	0
Industria perpunuese	5241
Industria energjise ujit	992
Ndertim	1810
Tregti	6506
Hotel restorant	1807
Transport komunikacion	3733
Aresim	2331
Shendetsi	1326
Te tjera	2561

Porti i Durresit, eshte percaktuar si nje pike hyrje per Korridorin e 8-te te transportit qe fillon nga Shqiperia, kalon nepermjet Maqedonise dhe Bullgarise per te mbritur ne portin e Varnas dhe Burgasit ne Detin e Zi. Objektiv i kryesor i projektit eshte krijimi i nje transporti te sigurt, sipas standarteve europian dhe nderkombetare.

Porti i Durresit, eshte porti me i madh i vendit dhe mbulon rreth 85% te import-eksporteve shqiptare te mallrave dhe me i rendesishmi ne transportin detar te udhetareve. Ai ka nje siperfaqe te pergjithshme prej 1.4 km<sup>2</sup> dhe nje akuatorium prej 0.67 km<sup>2</sup>. Ne port funksionojne 11 kalata operues nga 6.60 -11m te thella me nje gjatesi rreth 2.200m. Siperfaqja totale per depozitimin e mallrave eshte 270.000m<sup>2</sup> nga te cilat 27.000m<sup>2</sup> jane te mbuluara.

Ne portin e Durresit ngarkohen dhe shkarkohen te gjitha llojet e mallrave; minerale, karburante, cemento dhe artikuj te kategorive te ndryshme. Ne port gjendet dhe terminali i trageteve, i cili ka ne dispozicion nje kalate me gjatesi 186 ml dhe zhytje qe varion nga 7.40-7.90 ml. Ne kete terminal, gjate vitit 2002, u perpunuan 1.683 tragete me 600.500 pasagjere, 138.000 automjete dhe 368.000 ton mallra.

Si nje vend me burime te medha dhe zhvillim te shpejte te ekonomise, qarku i Durresit behet shume terheqes edhe per investitoret e huaj. Ne kete kontekst eshte per u theksuar fakti qe ne rrethin e Durresit operojne 89 subjektet me kapital te huaj.

**Pasqyra e ndermarrjeve me kapital te huaj**

Sektori	Nr. ndermarrjeve
Tregeti	21
Rrobaqepsi	26
Ndertim	15
Te tjera	16
Totali	78

Ne shkalle qarku numri me i madh i ndermarrjeve me kapital te huaj ushtrojne aktivitetin e tyre ne fushen e tregtise dhe prodhim veshjesh , ne kete te fundit futen rrobaqepesi me material porositesi. Keto subjekte klasifikohen ne grupin e ndermarrjeve me permasa te medha te numrit te punonjesve dhe te kapitalit.

### **5.7.2 Punesimi**

Reforma ekonomike e pas viteve 90, te shekullit te kaluar, pati si pasoje mbylljen e pothuajse te gjitha ndermarrjeve shtetore, pervec atyre te sherbimeve. Sektoret me te prekur ishin industria e rende dhe kimike, peshkimi dhe transporti. Si rrjedhoje, papunesia, e cili preku sidomos zonat urbane, u rrit ne menyre te theksuar.

Forcat aktive te punes ne rrethin e Durresit, per vitin 2007, llogariten ne 52,835 persona. Ne vitin 2003, numri zyrtar i te papuneve zinte 13.4% te forcave te afta per pune . Ne realitet, ky numer, mund te jete shume me i larte. Nga ana tjetere, shume njerez te punesuar ne sektorin privat, nuk jane te rregjistruar zyrtarisht si te punesuar, gje qe e veshtireson llogaritjen e sakte te numrit te te papuneve.

Ne vitin 2005, sipas te dhenave zyrtare, 78% e forcave te zena me pune, punonin ne sektorin privat. Rolin kryesor, ne punesimin e njerezve, qe me pare e mbanin industria e rende,

transporti dhe peshkimi, tani e zene industrit e ndertimit, tregetise dhe sherbimet, ne te cilat punojne rreth 30% e forcave te punes.

Niveli i papunesise per rrethin e Durresit per vitin 2007, arrin 9.80%, ku per vitin 2006, arrinte ne rreth 10,1% dhe per vitin 2005 arrinte ne 11.3%. Kjo do te thote se per vitin 2007, niveli i papunesise per rrethin e Durresit, ka ardhur ne ulje dhe konkretisht krahasuar me vitin 2005 eshte ulur rreth 1.5% dhe krahasuar me vitin 2006 eshte ulur 0.3%.

Ndarja e nderrmarrjeve, te rrethit te Durresit, sipas numrit te te punesuarve

Nr. punonjesve	Durres
1 i punesuar	4044
2-10 punesuar	839
> 10 punesuar	495
Total	5378

Ndarja e nderrmarrjeve sipas numrit te te punesuarve ne perqindje.

Nr. punonjesve	Pesha ne %
Ndermarrje vetiake ose te vogla me 1 punonjes	75%
Ndermarrje te vogla dhe te mesme 2-10 punonjes	15%
Ndermarrje te medha mbi 10 punonjes	10%

Tabelat e mesiperme japin nje situatë te permasave te nderrmarrjeve aktive sipas numrit te te punesuarve dhe perqindjes qe ato zene ne totalin e pergjithshem te tyre.

Të ardhurat mesatare mujore të familjeve qytetare shqiptare janë rreth 37.150 lekë per familje dhe rreth 9.310 lek per fryme. Komponenti kryesor perberes i te ardhurave familjare jane te ardhurat e rregullta nga puna dhe zene dy te tretat e tyre. Te ardhurat nga transfertat kryesisht private si dhe nga emigracioni zene 10 perqind te te ardhurave familjare gjithsej.

Komponente te tjere jane te ardhurat nga pronat, pensionet, etj. Shperndarja e tyre eshte e ndryshme midis tipeve dhe madhesive te ndryshme te familjeve.

Mbeshtetur ne te dhenat statistikore te Zyres Rajonale te Punes ne Durres per vitin 2007, numri i punekerkesve te papune te regjistruar gjithsej arrin ne 5.132 persona, nga te cilet 2,936 ose 57.2% jane femra dhe 2,196 ose 42.8% jane meshkuj.

Ne kete numur pjesen me te madhe prej mbi 45% e perben grupmosha mbi 45 vjec, ndersa po ti refrohemi niveli arsimor kategoria qe perben perqindjen me te madhe te kerkesave per pune eshte ajo me arsim 8 vjecar me 56% ndersa kategoria me arsim te larte eshte ne nivelin 4,3 %.

### 5.7.3 Arsimi

Rrethi Durresit eshte nje nder rrethet me sistem arsimor nga me te zhvilluarit. Perverc rreth 90 shkollave te arsimit dhe niveleve te ndryshme, publike dhe private ne vitin 2006 filloj te funksionojte edhe universiteti shteteror i ri me emrin "Aleksander Moisiu" me 3000 studente.

Gjate vitit 2007 shpenzimet e pergjithshme per arsimin parauniversitar u rriten ne 122% kundrejt vitit 2006. Keto shpenzime perfshijne shpenzimet operative per mirembajtjen dhe funksionimin e institucioneve te arsimit baze, te mesem te pergjithshem dhe profesional si dhe investimet ne kete sektor.

Ngritja e Universitetit te Durresit, nuk eshte thjesht nje Institucion mesimdhenie, por eshte qendra e debatit intelektual, qytetar, kulturor dhe shkencor, nje laborator i punesimit te ideve, projekteve dhe programeve te zhvillimit, nje promotor i zhvillimit rajonal dhe kombetare, nje oponent i fuqishem, autoritar dhe prestigjioz i klases dhe institucioneve politike, nje pike referimi per qytetin dhe vendin. Ne qytet funksionojne gjithashtu 28 kopshte femijesh nga te cilet 20 jane publike.

Arsimi i detyrueshem perfshin femijet nga klasa e pare, deri ne te nenten. Shpesh, ne kete kategori shkollash, femijet braktisin mesimin per tu marre me pune te vogla, ne ndihme te familjes, ose thjesht edhe per te mos u marre me asgje. Shkalla e braktisjes se shkolles rritet ne zonat fshatare dhe rrethinat e qyteteve, sikurse eshte edhe rasti zones ne fjale. Nuk ka te dhena te drejtperdrejta per kete zone, por ne shkalle prefektore, 5% e femijeve braktisin arsimin 9-vjecar.

Ndersa shkalla e zhvillimit te arsimit parashkollor ecen paralelisht me ate te nivelit social e kulturor te prinderve. Ne zonat informale, sikurse eshte edhe rasti i Porto Romanos, shumica e femijeve te moshes parashkollore nuk frekuentojne arsimin parashkollor

Ne disa zona sikurse eshte edhe rasti i rajonit ku do zbatohet projekti, pati nje kerkese te menjehershme per mjedise shkollore, pajisje e kabinete dhe personel pedagogjik. Dhjetevjecarin e fundit, ne rrethin e Durresit, rreth 2/3 e ndertesave te shkollave 9-vjecare dhe 3/4 e atyre te mesme, jane rikonstruktuar. Ne kete kuader futet edhe shkolla 9-vjecare "Met Hasa" e Porto Romanos, e cila eshte vendosur ne nje ndertese te re.

#### 5.7.4 Shendetesia

Sistemi shendetesor shteteror perbehet nga strukturat e sherbimeve paresore, dytesore dhe te rangut te trete. Sherbimi kryesor (primar), ne rrethin e Durresit, perfaqesohet nga 15 qendra mjekesore dhe 100 ambulanca. Ne zonat urbane, qendrat mjekesore sherbejne per 10.000-15.000 banore, ndersa ne zonat rurale per 4.000 -8.000 banore. 80% e fshatrave te prefektures se Durresit kane ambulanca.

Numri i personelit mjekesor eshte i pamjftueshem: 1 mjek per 1.000 banore. Numri me i madh i mjekëve ndodhet ne zonat urbane dhe ato fshatare fushore.

Ndotja e mjedisit ndikon, direkt dhe/ose indirekt edhe ne shendetin e njerezve. Nje nga aspektet e urbanizimit i pakontrolluar, i viteve 90, te shekullit te kaluar, ishte edhe shkaterrimi i mjedisve industriale, te braktisura pas ndryshimit te sistemit politik te vendit.

### 5.8 Perdorimi tokes

#### 5.8.1 Probleme te tokave bujqesore e joproduesore

Afersia me detin, rrugët relativisht të dendura të komunikacionit etj., kane bërë që gjatë shekujve ky rajon të jetë vazhdimisht në ndikimin e aftësisë shndërruese të njeriut qoftë kjo e fundit për mirë apo për keq.

Fushat e ultësirës bregdetare zakonisht mbulohej nga tokat e hirta kafe livadhore, te cilat jane mjaft pjellore, si edhe disa lloje tokash jozonale, siç janë tokat aluvionale, tokat moçalore dhe ato te kripura.

#### 5.8.2 Perdorimi i tokave bujqesore dhe siteve arkeologjike si siperfaqe ndertimi

Problemet kryesore ligjore dhe urbanistike, ne zonat informale, kane te bejne sidomos me perdorimin e trojeve, tokave bujqesore e sidomos shesheve arkeologjike, per ndertime pa leje.

Mosadaptimi i ndryshimeve urbanistike me ato te planeve te zhvillimit, ka cuar ne humbje te medha te pasurive arkeologjike, sikurse ka ndodhur se fundmi edhe ne veri te gjirit te Porto

Romanos, ku nje vendbanim arkeologjik eshte shkaterruar dhe/ose mbuluar pjeserisht nga ndertimi i nje grupi depozitash karburantesh.

### 5.8.3 Ndotja e tokes

Ne Porto Romano, sistemi i kanalizimeve eshte nje burim i perhershem ndotjeje. Ne kete zone, kanalizimet mbledhin njekohesisht si ujrat e shirave, ashtu edhe ujrat e zeza te qytetit te Durresit dhe fshatrave per rreth. Te gjitha keto ujra mblidhen ne nje kanal te hapur, i cili derdhet ne det, nepermjet hidrovorit te Porto Romanos.

Derdhja ne det behet pa kaluar me pare ne asnje lloj trajtimi per pastrim, duke patur si pasoje edhe ndotjen e ujit te detit..

Nje problem i mprehte per zonen e Porto Romanos, mbetet ish uzina kimike me mbetjet e lendeve te para dhe mbetjeve teknologjike, te braktisura ne qiell te hapur qe shkaktojne probleme mjedisore dhe ne shendetin e njeriut. Ky problem eshte bere me i mprehte, sidomos pas migrimit te popullsisë gjate viteve `90 te, ku siperfaqe te tera toke, te ndotur nga lendet kimike, jane populluar ne kushte jo te pershtateshme, mjedisore, urbanistike dhe higjeno-sanitare duke shkaktuar probleme mjaft serioze per popullsinë.

### 5.8.4 Furnizimi me uje

Durresi furnizohet me uje te pijshem nga shtresat ujembajtese te Fushe Kuqes. Nderhyrjet e shpeshta ne rrjet, kerkesa gjithmone ne rritje per uje per shkak te ndertimeve te reja, mosadministrimi i sakte i ujesjellesit, kane cuar ne mungesa te shumta te ujit te pijshem. Ne qytetin e Durresit, ne stinen e veres, lagje te tera furnizohen me uje te pijshem vetem per dy ore ne dite, ndersa ne zonat informale, nuk kane fare uje te pijshem ne stinen e veres. Ne kete periudhe, ky uje sigurohet nepermjet autoboteve te ardhur nga ndermarrja e ujesjellesit te qytetit te Durresit.

### 5.8.5 Ujrat e ndotura

Qyteti i Durresit si gjithë qytetet e tjera te vendit i shkarkon ujrat e zeza pa kurfare trajtimi ne detin Adriatik. Ato perfundojne ne det nepermjet stacionit te pompimit (hidrovorit) te Porto Romanos qe sherben njekohosisht edhe per kullimin e ish kenetes se Durresit. Kjo situatë

pritet te ndryshoje me projektin qe po realizon Banka Boterore dhe Qeveria Shqiptare per trajtimin e ujrave te ndotura te qytetit ne nje impiant pastrimi te tipit lagune artificiale.

Aktualisht nje nder problemet me te theksuara mjedisore eshte ndotja e zones se plazhit te Durresit sidomos gjate periudhes se veres; ne muajt qershor – shtator, kur dhe numuri i pushuesve eshte me i madh.

Ndertimet e shumta pa kritere te mirefillta urbanistike, mungesa e kanalizimeve te ujrave te zeza, perdorimi pa kriter i gropave spetike, shkarkime e drejt perdrejta ne det te ujrave te ndotura, mungesa e WC-ve publike, kane shkaktuara nje ndotje pertej normave te lejuara nga Organizata Boterore e Shendetesise per ujin, ne segmenteve te caktuara zones se plazhit, e cila tashme eshte e faktuar edhe nga rezultatet e monitorimeve te bera nga ISHP.

Ne programin e monitorimit per plazhin e Durresit perfshihet plazhi i Currilave, Zhiron, Ura e Dajlanit e deri ne Golem (Giardino). Ne kete plazh perfshihen 20 stacione kampionimi, te cilet shtrihen nga Currilat deri ne Shkembn e Kavajes.

Cilesia mikrobiologjike e ujrave te larjes ne plazhin e Durresit ne stacionet e kampionimit: Apollonia, Hekurudha, Ministria e Rendit, Benilva dhe Hotel Andi paraqitet brenda normave te rekomanduara per larje, sipas Organizates Boterore te Shendetesise dhe UNEP.

Stacionet me te ndotura kane rezultuar, Plepat, Shkemb i Kavajes, te konstatuara mbi normat e rekomanduara nga OBSH si per vlerat minimale ashtu dhe per ato maksimale te mikroorganizmave indikatore te ndotjes fekale.

Sipas rekomandimeve te reja te WHO/UNEP nepermjet 95% te Streptokokeve fekale FS, te gjitha stacionet e kampionimit rezultojne ne kategorine C dhe D pra te ndotura dhe shume te ndotura, ndersa disa stacione kampionimi si Shkemb i Kavajes, kategoria D, ku duhen marre masa urgjente.

### 5.8.6 Mbetjet urbane


Me poshte, jepen te dhenat qe kane te bejne me mbeturinat e trajtuara rrethin e Durresit

Mbeturinat urbane ne vitet 2002-2006

Viti	2002	2003	2004	2005	2006
Bashkia Durres	50581	54037	55928	59530	62677



Qyteti i Durrës ka një peshe mbizotëruese ndaj komunave të tjera dhe sasia e tij paraqet 52% të mbeturinave të trajtuara në Qark, kjo është e lidhur edhe me shkallën e lartë të prodhimit të mbetjeve urbane që ka ky qytet si qendër e zhvillimit ekonomik të Qarkut. Në figurën në vijim jepet sasia e mbeturinave në ton, e administruar në vitet 2002-2006 në rrethin Durrës.



Sasia e mbeturinave urbane, në vitet 2002-2006, sipas komunave

Keto shifra, kanë të bëjnë vetëm me mbeturinat e administruara nga shërbimet e grumbullimit, pra përbejnë vetëm një pjesë të mbeturinave të prodhuara, që në pjesën më të madhe braktisen përgjatë rrugëve në periferi të qendrave të banuara.

Të dhënat e mësipërme kanë të bëjnë me mbeturinat në qendrat urbane sepse në zonat fshatare mbeturinat shpërbehen nga banorët, pra vetëm një pjesë e popullsisë mbulohet nga shërbimi i organizuar i mbledhjes, pra nga shërbimi i strukturuar, i mbështetur në:

- përdorimi i mjeteve për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave;
- vendosjen e kazaneve brenda zonës së shërbimit;
- mbledhjen e kryer me frekuencë ditore sipas një internerari të paracaktuar; si dhe
- dorezimi i materialit të mbledhur në vende të caktuara.

Nga kjo pikpamje, qendrat ku është aktiv shërbimi i mbledhjes së mbeturinave janë bashkitë Durrës, Krujë, Shijak, Manëz, Krujë, Fushe Krujë dhe Komunitat Katund i Ri e Xhafzotaj.

Në komunat ku nuk ka sistem mbledhje të organizuar, këto mbeturina thjesht largohen nga qendrat urbane dhe shkarkohen në periferi, zakonisht përgjatë skarpateve dhe pranë shtretërve të lumëjve e perrenjve.

### 5.8.7 Transporti publik dhe sherbimet

Rrethi i Durresit eshte nje qender e rendesishme e linjave te transportit kombetar e nderkombetar. Durresi eshte nje pike takimi e arterieve kryesore te transportit detar e atij tokesor, qofte ky automobilistik apo hekurudhor.

#### Transporti rrugor

Per shkak te pozicionit te tij gjeografik, qyteti i Durresit pershkohet nga arteriet kryesore rrugore te vendit. Per shkak te gjendjes se keqe te transportit hekurudhor, transporti rrugor eshte i zhvilluar jo vetem per njerzitet, por edhe per mallrat. Durresi ze vendin e dyte, ne shkalle vendi, per numrin e automjeteve te transportit rrugor (16% te automjeteve te transportit te mallrave dhe 13% te atyre te njerziteve).

Transporti publik, ne rrethin e Durresit, vuan nga gjendja e keqe e rrugëve, sidomos atyre rurale. Ky fakt demton rende edhe tregetine e bujqesine vendase, sepse fshataret kane veshtiresi per te transportuar prodhimet e tyre bujqesore e blegtorale.

#### Transporti hekurudhor

Hekurudhat administrohen nga Drejtoria e Pergjitheshme e Hekurudhave me qender ne Durres. Linja e pare hekurudhore ne Shqiperi eshte ndertuar ne vitin 1947, ndonese disa linja te shkurtera dhe te ngushta kane ekzistuar edhe me pare kesaj kohe. Ekziston vetem nje linje nderkombetare hekurudhore qe lidhe Shqiperine me Malin e Zi (Shkoder – Podgorice) per transportin e mallrave dhe qe aktualisht qarkullimi i ndersjellte i mallrave nepermjet kesaj linje po shtohet.

Mbas vitit 1990 me ndryshimin e regjimit politik dhe ekonomik, u lejua perdorimi i mjeteve private te transportit gje qe shkaktoj nje renie te transportit hekurudhor i cili mbeti dhe vazhdon te jete shteteror dhe rritje te transportit automobilistik, fal kjo edhe permiresimit progresiv te infrastruktures rrugore.

#### Transporti detar

Transporti detar eshte mjaft i zhvilluar, ne saje te portit me te madh te vendit, i cili perpunon cdo vit rreth 27 milione tone mallra, te cilat perbejne 78% te transportit detar te vendit. Neper portin e Durresit kalojne gjithashtu edhe 80% e pasagjereve qe udhetojne me det.

Ne planet e qeverise shqiptare, porti i Durresit, figuron ne listen e infrastruktures qe do te rehabilitohet e permiresohet, duke e kthyer ne nje port me parametra bashkekohore per

manipulimin e mallrave dhe pasagjeret. Ne kete kuader, futet edhe zhvendosja depozitave te hidrokarbureve, nga territori i ketij porti, ne Porto Romano.

Porti i Durresit eshte percaktuar si nje pike hyrje per Korridorin e 8-te te transportit qe fillon nga Shqiperia, kalon nepermjet Maqedonise dhe Bullgarise per te mbriritur ne portin e Varnas dhe Burgasit ne Detin e Zi.

Objektivi kryesor i projektit eshte krijimi i nje transporti te sigurt, sipas standarteve te projektimit europian dhe nderkombetare. Gjithashtu eshte porti me i madh i vendit, i cili mbulon rreth 85% te import-eksporteve shqiptare te mallrave dhe me i rendesishem ne transportin detar te udhetareve.

Porti i Durresit ka nje siperfaqe te pergjithshme prej 1.4 km<sup>2</sup> dhe nje akuatorium prej 0.67 km<sup>2</sup>. Kanali i hyrjes eshte 9.5m i thelle, 40 ml i gjere dhe 1.2 milje i gjate. Ne port funksionojne 11 kalata operues nga 6.60 -11m te thella me nje gjatesi rreth 2.200m. Siperfaqja totale per depozitimin e mallrave eshte 270.000m<sup>2</sup> nga te cilat 27.000m<sup>2</sup> jane te mbuluara.

